



Botim i Qendrës “Aleanca Gjinore për Zhvillim”

Barazia Gjinore dhe Vendimmarrja

Përmbledhje artikujsh

Tiranë, Maj 2005

Kjo përmbledhje artikujsh botohet në kuadrin e projektit “Përmirësimi i balancës gjinore në vendimmarrje”, i financuar nga Ministria e Jashtme Austriake dhe Organizata Austriake për Zhvillim e Bashkëpunim, Horizont 3000. Opinionet, konkluzionet apo rekomandimet e shprehura në këtë material, i përkasin autorëve dhe jo Qeverisë Austriake.

Përgatiti për botim: Elvana Lula, koordinatore projekti

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për Qendrën “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë, Shqipëri.

Adresa:

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”

Kutia postare 2418, Tiranë

Tel. & Fax: (355) 4 255514/5

E-mail: info@women-center.tirana.al

Këtë botim mund ta gjeni në formë elektronike në adresën:

<http://www.women-center.org.al>

Design & Layout: Vjollca Ruvina

Shtëpia botuese & Shtypshkronja

PEGI

Rr. Elbasanit, Përballë Fakultetit Filologjik

Tel&Fax: 374947. Mobil: 069 20 26 773

E-mail: pegi@icc-al.org

Tiranë

Përmbajtja

Hyrje _____	5
<i>Afroviti Gusho</i>	
Lëvizja e gruas dhe pengu i vendimmarrjes _____	7
<i>Dolly Wittberger</i>	
Subjekti i gjinizuar politik: Rimarrja në konsideratë e qytetarisë dhe demokracisë _____	12
<i>Martin Leka</i>	
Gratë në politikë dhe politika e burrave _____	17
<i>Eglantina Gjermani</i>	
Gratë në politikë si cilësi e demokracisë _____	20
<i>Zefina Hasani</i>	
Aromë gruaje _____	26
<i>Elda Spaho</i>	
Universitetet: Vendimet merren nga burrat _____	33
<i>Lavdie Ruci</i>	
Pse lihet mënjane gruaja nga vendimmarrja?! _____	36
<i>Kristi Pinderi</i>	
Ëmbëlsi kompromentuese! _____	40
<i>Ermira Danaj</i>	
6.4, 30 apo X %? _____	42
<i>Dorina Hamzallari</i>	
Gratë në drejtim - Shtrohet rruga që brezat e rinj të arrijnë më larg _____	45
<i>Zefina Hasani</i>	
Tani është radha jonë _____	49
<i>Flora Nikolla</i>	
Gratë, politika dhe kriteret e barazisë _____	55
<i>Laureta Roshi</i>	
Botë të ndryshme në postera “bambolash” _____	57

<i>Antoneta Malja</i> Përse hezitohet që gratë të kandidojnë?! _____	59
<i>Isidor Koti</i> Gratë në politikë, sfidë dhe realitet _____	62

Hyrje

Organizimi i një fushate ndërgjegjësimiti lidhur me pjesëmarrjen e gruas në vendimmarrje, përbën një nga aktivitetet kryesore të projektit *Promovimi i balancës gjinore në vendimmarrje*, i financuar nga Ministria e Jashtme Austriake dhe Zyra Austriake për Zhvillim e Bashkëpunim, Horizont 3000. Kjo fushatë ndërgjegjësuese pati një shtrirje kohore prej tre muajsh (mars-maj 2005), gjatë së cilës, u shkruan dhe u botuan 14 artikuj në shtypin e përditshëm shqiptar. Autorët e përfshirë, janë figura të njohura të gazetarisë, shoqërisë civile si dhe ekspertë të çështjeve të përkatësisë gjinore në Shqipëri dhe jashtë saj.

Botimi që paraqitet për publikun, është një përmbledhje e këtyre artikujve, të cilët pasqyrojnë, përmes një analize të thellë, përfaqësimin e ulët të gruas në nivelet vendimmarrëse në Shqipëri. Autorët janë ndalur në analizimin e faktorëve kryesorë, që kanë çuar në këtë përfaqësim të ulët të grave në vendimmarrje sot. Një rëndësi të veçantë i është kushtuar rolit që shoqëria civile mund dhe duhet të luajë në Shqipëri, për rritjen e përfaqësimit të grave në vendimmarrje. Kështu, në artikullin e saj, autorja Afroviti Gusho, vë në dukje faktin se politika do ta humbiste dimensionin e saj pa presionin e shoqërisë civile, dhe se një shoqëri civile aktive është për politikanin, si busulla për marinarin. Të një një rëndësie të veçantë, janë artikujt e shkruar nga gazetarët meshkuj. Kështu, në shkrimin e tij, gazetari Martin Leka, vë në dukje faktin se partitë politike shqiptare ende sundohen nga mentaliteti *se burrat janë të lindur për politikë*. Siç shprehet ky autor, - *“këta burra të politikës duhet të kenë më shumë besim tek aftësitë e grave dhe jo të lexojnë statistika standarte për pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje në përgjithësi, e në politikë në veçanti*.

Vlejnë për t'u përmendur përvojat e disa prej kandidateve gra, që do të përfshihen në këto zgjedhje parlamentare,

duke përfaqësuar forcat kryesore politike në vend. Përmes shkrimeve të saj, gazetarja Zefina Hasani, sjell tek lexuesit përvojën personale, sfidat, vështirësitë që këto gra kanë marrë përsipër në këtë garë të vështirë elektorale. Krahas artikujve të shkruar nga gazetarë e analistë shqiptarë, kësaj inisiative i është bashkuar specialistja e çështjeve të përkatësisë gjinore, Znj. Dolly Wittberger, e cila ka sjellë në artikullin e saj një vizion të ri të qytetarisë dhe përkatësisë gjinore; si ndërthuren këto dy çështje me njëra-tjetrën dhe si mund të analizohen çështje të lidhura me qytetarinë, nën këndvështrimin e përkatësisë gjinore.

Dëshiroj t'i kushtoj një falenderim të veçantë Ministrisë së Jashtme Austriake dhe Horizont 3000 për mbështetjen e vlefshme që i kanë kushtuar financimit dhe zbatimit të këtij projekti në promovimin e barazisë gjinore në vendimmarrje. Duke u uruar sinqerisht shumë suksese dhe fitore të gjitha kandidatëve gra të të gjitha forcave politike, shpresojmë që ky botim t'u shërbejë atyre dhe gjithë shoqërisë shqiptare, si një mjet i domosdoshëm advokacie gjatë fushatës elektorale. Gjej rastin të falenderoj gjithashtu, të gjithë autorët e këtyre artikujve, për kontributin e tyre të rëndësishëm, për analizën e thellë të situatës, rekomandimeve e sugjerimeve të tyre e, mbi të gjitha, për mesazhin që ata përcollën: *promovimin e barazisë gjinore në vendimmarrje*.

Eglantina Gjermeni

Drejtoreshë Ekzekutive

Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim

Lëvizja e gruas dhe pengu i vendimmarrjes ¹

Afroviti Gusho

Fakte nga Bota

Në mbarë globin gratë janë dramatisht të papërfaqësuar në qeverisjen qendrore dhe në parlament. Duke i referuar statistikave dhe të dhënave nga Unioni Ndërparlamentar - IPU, rezulton se në nivel ndërkombëtar gratë zënë 15.7% të vendeve në parlament.² Duke i referuar burimit të mësipërm, vendet arabe kanë përfaqësim më të ulët të grave në parlament, vetëm 6.5% dhe përqindja e grave të përfaqësuar në parlamentet e kontinentit Amerikan është 18.6%. Një situatë e ngjashme paraqitet në Europë, ku përqindja e grave në parlament (përveç vendeve nordike) është 18.5%. Vlen për t'u theksuar fakti se vendet e Europës Veriore janë në krye të listës përse i përket kësaj përqindjeje, me Suedinë në vend të parë me rreth 44%. Këto shifra tregojnë se pothuajse të gjitha vendet, drejtojnë politikën në mënyrë të tillë, që përjashtojnë afërsisht gjysmën e burimeve dhe talenteve të tyre njerëzore.

Jo vetëm në politikë, por edhe në institucionet financiare dhe organizatat ndërkombëtare, të tilla si: Bashkimi Europian, Kombet e Bashkuara, NATO, Banka Botërore dhe grupet e tjera të fuqishme, burrat vazhdojnë të mbizotërojnë pozitën drejtuese.

Në këtë prag fushate elektorale pjesëmarrja e gruas në politikë është bërë pjesë e diskutimeve të grave, anëtare të partive politike apo jo, grave të angazhuara në lëvizjen e gruas në

¹ Botuar për herë të parë në gazetën "Shekulli", datë 18 Maj 2005, faqe 14.

² <http://www.ipu.org/wmn-e/world.htm>. Vizituar për herë të fundit më 23 Maj 2005.

Shqipëri, politikanëve e analistëve të medias.

Tashmë është fakt: Në Shqipëri, pjesëmarrja e gruas në proceset vendimmarrëse në përgjithësi dhe në politikë në veçanti, mbetet në nivele shumë të ulëta në krahasim me vendet e tjera të Europës Lindore e Qendrore.

Ligji aktual shqiptar duket se nuk e favorizon këtë. Një mazhoritar i përzier me proporcional nuk premtonte kuota të përcaktuara qartë për gratë. Vullneti i partive politike për të futur përqindjet e pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrje ka mbetur në letër.

Kemi kohë që debatojmë:

- Pse duhet gruaja në politikë dhe në jetën publike?
- Cilat janë pengesat për pjesëmarrjen e gruas në politikë?
- Si duhet realizuar procesi i rritjes së rolit të gruas në vendimmarrje?

Unë doja të ndalesha tek kjo pyetje e fundit dhe ta trajtoja nga këndvështrimi i rolit që mund e duhet të luajë në këtë proces shoqëria civile në përgjithësi dhe lëvizja e gruas në veçanti, *Cili është roli i OJF-ve për rritjen e pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrje?*

Do të citoj Viola Furubjelke:³

“OJF-të dhe partitë politike janë pjesë plotësuese të njëra-tjetrës. Pa presionin e shoqërisë civile, politika do të humbiste një dimension të rëndësishëm. Një shoqëri civile aktive është për politikanin, si busulla për marinarin. Por, vartësia është reciproke. OJF-të gjithashtu kanë nevojë për politikanët, nëse puna e tyre nuk do të kufizohet vetëm në parullat e banderolave. Në një shoqëri të shëndoshë demokratike OJF-të dhe partitë politike punojnë paralelisht, duke respektuar plotësisht kushtet e njëra-tjetrës.”

³ Viola Furubjelke, Ambasadore e Suedisë në Liban dhe Siri, ish kryetare e Komitetit për Punët e Jashtme në Parlamentin Suedez.

Organizatrat që punojnë për mbrojtjen e të drejtave të grave në Shqipëri kanë luajtur një rol të rëndësishëm gjatë periudhës pas viteve '90 për evidentimin e problemeve të grave e vajzave dhe rolin e tyre në shoqëri, si dhe kanë bërë përpjekje për plotësimin e kuadrit ligjor që mbështet gruan dhe garanton barazinë gjinore. Po kështu, është draftuar ligji për dhunën në familje dhe është hedhur për diskutim në grupet e interesuara. Janë bërë trajnime të shumta për gruan në leadership dhe janë zbatuar programe në nivel lokal e kombëtar që iu kanë dhënë grave kandidat apo të zgjedhura mundësi të promovojnë veten, të tregojnë aftësi manaxhimi dhe të përfshihen në drejtim e vendimmarrje. Mund të listoja një numër të madh suksesesh të lëvizjes së gruas në Shqipëri, që kanë çuar në përmirësimin e statusit aktual të gruas shqiptare.

Çështja e pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrje duhet të vijë në rend të ditës. Jo vetëm në prag fushatash elektorale dhe jo vetëm si demagogji; jo vetëm si një proces i copëzuar në intervale 3 e 4 vjeçarë, në kohë zgjedhjesh për pushtetin vendor e atë qendror.

Por faktet janë kokëforta. Pjesëmarrja në vendimmarrje është e ulët. Kjo tashmë është evidentuar me shifra duke krahasuar përfaqësimin e gruas në Parlamentin e vitit 2001 - ku ka aktualisht 132 deputetë burra dhe vetëm 9 gra deputete, me vitin 1997- ku ka pasur 144 deputetë burra dhe 11 gra deputete.

E njëjta pamje e mjeruar është dhe në pushtetin vendor. Pas zgjedhjeve të fundit vendore (tetor 2003) kemi vetëm 3 gra kryetare në njësitë bashkiake dhe 6 gra kryetare komune.

Mendoj se lëvizja e gruas në Shqipëri, megjithë përpjekjet dhe projektet e shumta të zbatuara, pothuajse ka dështuar në nismën e saj për të rritur pjesëmarrjen e gruas në vendimmarrje.

Çështja e pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrje duhet të vijë në rend të ditës. Jo vetëm në prag fushatash elektorale dhe jo vetëm si demagogji; jo vetëm si një proces i copëzuar në intervale 3 e 4 vjeçarë, në kohë zgjedhjesh për pushtetin vendor e atë qendror. Jo vetëm me disa përpjekje për ta trajtuar në media si një mangësi të shoqërisë shqiptare dhe kaq. Jo vetëm për të dhënë disa fakte, por për t'i bërë një analizë të gjerë këtij fenomeni që e sjell shoqërinë shqiptare të përfaqësuar mangësisht në strukturat vendimmarrëse të saj.

Eshtë detyrë e OJF-ve të grave ta sjellin këtë diskutim në rend të ditës. Eshtë detyrë e tyre të hartojnë një strategji afatgjatë për ndryshim. Pasi ta kenë bërë pjesëmarrjen e gruas në vendimmarrje një çështje që kërkon ndryshim urgjent, duhet të llobojnë me aktorë të tjerë të shoqërisë shqiptare:

- **Me gratë** që janë tashmë në vendimmarrje. Ato mund të krijojnë lobin e tyre për të ndikuar tek vendimmarrësit burra, të llobojnë bashkë me ta, që pjesëmarrja e gruas të mos mbetet si slogan modern i ndonjë fushate afatshkurtër të partive.
- **Me median**, për të hartuar një strategji, si ta përdorim median për të analizuar këtë handicap të shoqërisë shqiptare, për krijuar imazhin e vërtetë të gruas, për të promovuar gra në lidhshmëri, gra që sjellin ndryshime për shoqërinë shqiptare, për të treguar në mënyrë realiste arritje e suksese të shoqatave të grave dhe individëve të shquar të lëvizjes së gruas në Shqipëri.
- **Me organizatat ndërkombëtare e donatorë** që kanë akses në ndikimin e politikave e politikëbërësve të vendit tonë, që hartojnë raporte mbi arritjet e demokracisë në Shqipëri, për të prezantuar në këto raporte vënien në veprim të një nga Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit në Shqipëri, atë të nxitjes së barazisë gjinore dhe fuqizimit të gruas, që shkallën më të lartë të arritjes së tij ka atë të vendimmarrjes së gruas, përfaqësimin e saj, të kërkojnë sigurimin e barazisë gjinore në përfaqësimin politik.

Rezultatet e para duhen kërkuar në vendimmarrjen lokale

Eshtë më e thjeshtë të krijohen aleanca të OJF-ve të grave e forumeve të grave pranë partive politike, për të ndikuar në futjen e kuotave në listat e kandidatëve për në këshillat bashkiake e të komunave. OJF-të lokale duhen të marrin nisma që promovojnë gratë më aktive në zonat ku ato kryejnë veprimtarinë e tyre. Ato mund të ideojnë projekte për trajnimin e grave që synojnë përfaqësimin e tyre në pushtetin lokal, duke i mbështetur me njohuri e trajnime që do t'i bënin ato të afta të kontribuonin në

zgjdhjen e problemeve ekonomike e sociale në komunitetin ku ato jetojnë e veprojnë. Gjithashtu, mund krijohen modele pilot. Në bazë Bashkie, Komune e Qarku, mund të llobohet që gratë të zënë pozicione drejtuese dhe atje ku zgjedhjet nuk bëhen me votime të drejtpërdrejta, por me emërime nga lart. Mund të llobohet kontretisht për këto pozicione drejtuese: Prefektura, Drejtoria Arsimore, Institucione të ndryshme shtetërore etj.

Ka diskutime që OJF-të e grave duhet të mbështesin gratë kandidate gjatë fushatave të ndryshme, pavarësisht nga pozicioni partiak që ato kanë. Këtu unë kam rezervat e mia. Është vështirë të lobosh në këto momente. Në Shqipëri ende elektorati shkon i orientuar nga Partia, majtas apo djathtas, drejt qendrës, apo ekstremeve, dhe jo aq nga vlerat që përfaqëson kandidati si person. Kjo është shumë e theksuar, si gjatë zgjedhjeve për deputetë në Parlament, ashtu edhe për kryetarë bashkie e komune. Mendoj që në hapësirën kohore midis dy legjislacioneve apo viteve ndërmjet zgjedhjeve parlamentare apo për pushtetin vendor, OJF-të duhet të kenë kryer misionin e tyre, shtysën për ndryshime legjislacioni, futjen e kuotave të përfaqësimit të grave etj.

Në kohë fushatash, mendoj që pozicionimi krahas një kandidateje me ngjyra partiake do të cënonte imazhin e OJF-ve, do ta poziciononte atë në një kah partiak e do të dëmtonte pavarësinë e saj. Është vështirë të lobosh gra që të votojnë për një grua me një pikëpamje të caktuar partiake, apo thjesht një grua nga shoqëria civile që zgjidhet si kandidate në një fushatë prej një partie politike. Këtu do të fillonin paragjykimet që mund të dëmtonin brishtësinë e shoqërisë civile e sidomos të lëvizjes së gruas.

Mendoj që *shoqëria civile mund t'u ofrojë kandidatë partive*. Partitë mund të duan të huazojnë personazhe të shquar nga shoqëria civile, por kur ky anëtar i shoqërisë civile burrë apo grua qoftë, hyn në garën politike, rregullat e lojës janë të njëjta për të gjithë. Këtu shoqëria civile e ka përfunduar rolin e saj, ka krijuar figura e personalitete, për të cilët nis një sfidë e re.

Subjekti i gjinizar politik: Rimarrja në konsideratë e qytetarisë dhe demokracisë⁴

Dolly Wittberger

Që me mbajtjen e Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Gratë, në vitin 1995 në Pekin, kërkesa për përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e barabartë të gruas në jetën politike, është kthyer në gurin e themelit për axhendën e qeverisjes së mirë nën këndvështrimin e përkatësisë gjinore. Kjo reflektohet në planet lidhur me Objektivin e Tretë të Mijëvjeçarit, politikat e Bashkimit Europian, Organizatën për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik/Komiteti i Asistencës së Zhvillimit, Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara e Bankën Botërore, dhe veçanërisht përmes përpjekjeve të organizatave të shoqërisë civile në përfaqësimin e interesave të grave për të lobuar dhe zhvilluar fushata ndërgjegjësuese në mbrojtje të këtyre interesave.

Sidoqoftë, veçanërisht për vendet në tranzicion dhe në ato me demokraci të re, ku, në parim, janë hapur dritare të shumta mundësisht të barabarta, shifrat aktuale janë ende shqetësuese. Në këtë kontekst, përqindja e grave në parlament, si një tregues për fuqizimin e grave dhe pjesëmarrje e barabartë në politikë, është 6.4% për Shqipërinë, 7.9% për Serbinë dhe Malin e Zi, 11.2 % për Rumaninë dhe 19.2% për Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.⁵

⁴ I pabotuar.

⁵ Inter-Parliamentary Union, bazuar në informacionin e siguruar nga Parlamentet Kombëtarë, deri në 30 Prill 2005: <http://www.ipu.org/wmn-e/classif.htm>

Kërkesa për përfaqësim të barabartë rritet prej faktit se gratë përbëjnë 50% të popullsisë dhe se si gratë, ashtu edhe burrat, duhet të përfaqësohen në organet që marrin vendime për jetët e tyre. Kjo kërkesë merr në konsideratë ndryshimet në realitetet jetësore dhe interesat e grave, në krahasim me ato të meshkujve, si dhe pozicionimin e tyre të pabarabartë përsa i përket pushtetit.⁶ Mungesa e grave, për pasojë, të drejton në një krizë të thellë demokracie dhe vë në dyshim statusin e grave dhe grupeve të marginalizuara si qytetarë të vërtetë të një kombi, në emër të gëzimit të të drejtave të tyre njerëzore.

Me qëllim që të kuptohen arsytet më thelbësore lidhur me numrin e ulët të përfaqësimit të grave në jetën politike, është e rëndësishme që të analizohet me kujdes sesi është ndërtuar subjekti politik: Kush mund të jetë një aktor politik, dhe, për pasojë të gëzojë të drejtat si dhe statusin e një qytetari/eje të vërtetë?

Teoria politike liberale – e cila shërben si themel i të drejtave njerëzore, kushtetutave dhe numrit më të madh të ligjeve – e koncepton modelin qytetar si një qenie neutrale, pa gjini, klasë, etni, racë, përvoja, aftësi dhe lidhje shoqërore. Kjo krijon një njëtrajtshmëri çorientuese/mashtroese që, jo vetëm fsheh burimet dhe marrëdhëniet e pushtetit në jetën reale, por edhe errëson dhe bën të ligjshme pabarazitë reale midis kategorive të ndryshme të njerëzve. Nën fjalën neutrale “qytetar/e”, në çdo shoqëri ekziston një privilegjim i disa kategorive njerëzish, si një normë për qytetarin apo subjektin politik. Duke e analizuar më imtësisht, këto kategori individësh, përgjithësisht përfaqësojnë meshkujt, brenda një grupi dominant në shoqëri. Kështu, ato që janë përcaktuar si të drejta uniforme/të njëtrajtshme për të gjithë qytetarët, në fakt janë ‘tituj’ që përputhem kryesisht me nevojat dhe interesat e meshkujve dominues në shoqëri. E

⁶ Phillips, A. (2002) “Përfaqësimi i ndryshimit: pse duhet të ketë rëndësi fakti nëse një grua zgjidhet ose jo?” A. Coote (ed.) *New Gender Agenda*, London; IPPR

konsideruar në mënyrë të përgjithshme, aplikimi i standarteve të barabarta për të gjithë qytetarët, bëhet i pakuptimtë, ndërkohë që në të vërtetë, disa grupe qytetarësh janë të ndryshëm dhe të pabarabartë.⁷

Përveç kësaj, në teorinë politike liberale ka një dallim të konsiderueshëm midis privates/personales si dhe publike/politikes. Duke pasur parasysh që autonomia e individit është e garantuar që në lindje, liberalizmi e njih nevojën e shtetit për të vendosur rregull mes individëve në të gjitha sferat e jetës. Si rezultat, të drejtat që qytetarët mund të gëzojnë, janë vetëm ato që kanë të bëjnë me aspektet “publike” të jetës. Aktivitetet në këtë sferë përfshijnë për shembull, biznesin, politikën, politikë-bërjen dhe vendimmarrjen. Këto aktivitete janë të lidhura me pushtetin dhe ndikimin, si dhe konsiderohen të rëndësishëm. Tradicionalisht kjo sferë i është atribuar meshkujve.

Nga ana tjetër, sfera “private” është ajo që i përket shtëpisë dhe familjes. Ajo përfshin rolin riprodhues dhe aktivitetet përkujdesëse - veprime këto që konsiderohen si pjesë e rutinës së përditshme. Kjo sferë konsiderohet të jetë domeni i grave. Një pasojë e drejtpërdrejtë është fakti që pabarazitë gjinore që dalin më në pah, si rezultat pabarazive në pushtet në marrëdhëniet “private”, nuk njihen si të drejta të nevojshme.

Në nivelin konceptual, ndarja publike/private çon në vendosjen e një aktori politik, që i përket grupit dominant të shoqërisë (p.sh: i bardhë, mashkull, i arsimuar, heteroseksual dhe ekonomikisht aktiv). Gratë dhe grupet e tjera të shoqërisë, që nuk i përkasin kësaj kategorie, nuk merren në konsideratë si aktorë politikë. Për pasojë, të drejtat dhe nevojat e tyre nuk bëjnë pjesë në “arenën” dhe çështjet primare të politikës.⁸

⁷ Phillips, A. (1992) “Feminism, Equality and Difference” in Defining Women. Social Institutions and Gender Divisions, Cambridge; Polity Press

⁸ Lister, R. (1997) Citizenship: Feminist Perspectives, Basingstoke; Macmillan

Kriza e tanishme shumë e ashpër lidhet me dilemën sesi ne mund të jemi politikisht të barabartë, pavarësisht ndryshimeve tona. Me qëllim që të gjenden përgjigje të suksesshme, së pari është e nevojshme të tejkalohet modeli liberal i një qytetari neutral, i cili në praktikë, është i pakuptimtë për shumicën e njerëzve. Çka është e nevojshme të ndërmerret, është ripërcaktimi i konceptit të qytetarisë, si një e drejtë e barabartë për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse në jetën sociale, ekonomike, kulturore dhe politike. Kjo, si rrjedhim, është një formë ndërmjetësimi e praktike, duke vënë theksin në aftësimin e burrave dhe grave për të vepruar si agjentë dhe të përfshihen në vendime, të cilat ndikojnë jetët e tyre. Ky ndërmjetësim bazohet në idetë, nevojat, përvojat personale dhe në vetë-organizim. Si aktorë të mundshëm, gratë dhe burrat nevojitet të angazhohen në dialogje me siguresit e shërbimeve, duke shprehur shqetësimet e tyre dhe duke kërkuar përgjegjësi si dhe mekanizma monitorues nga institucionet përgjegjëse.⁹

Ky fakt shkon në një linjë me diskutimet në nivel global, ku agjenda e qeverisjes së mirë është përfshirë në përpjekjet e proceseve reformuese në sferat ekonomike, administrative dhe elektorale. Për këtë axhendë është e domosdoshme që qeveria të jetë përgjegjëse për politikën e saj (si burrat, ashtu edhe gratë!), transparente, kompetente dhe që respekton ligjin e të drejtat njerëzore. Sidoqoftë, parimi i barazvlerës, i cili kërkon vendime në nivelin e qeverisjes qendrore, me qëllim përfitime të barabarta për burrat dhe gratë, ka mbetur një nga kërkesat më pak të ngritura në debatet aktuale mbi qeverisjen e mirë.

Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë dhe e qartë e aktorëve –burra dhe gra – në jetën publike është parakusht për arritjen e qytetarisë së pavarur. Qytetaria e pavarur është një status, që parashikon të drejta, por që përfshin dy aspekte thelbësore: a) është një

Për pasojë, qytetarët e fuqizuar angazhohen në formimin e politikave, në ngritjen e të drejtave të reja, dhe në ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve për t'u përgjigjur dhe për t'u marrë në konsideratë prej tyre.

⁹ Goetz, A-M. and Gaventa, J. (2001) Bringing citizen voice and client focus into service delivery, IDS Working paper 138

Në mënyrë të veçantë, qytetaria e pavarur çon në përfshirjen e grave si subjekte dhe aktore politike të drejtave të tyre – përtej roleve të tyre të atribuara nga shoqëria si nëna, bashkëshorte dhe bija.

praktikë që përfshin pjesëmarrjen politike të burrave dhe grave në një kuptim të gjerë; dhe b) është një kusht aktiv i individëve për t'i bërë të drejtat të vërteta për të gjithë. Me qëllim që të arrihet e drejta për të marrë pjesë dhe për të qenë agjentë ndryshimi, individëve u duhet të fitojnë pushtet për të identifikuar mungesën e të drejtave të tyre.

Për pasojë, qytetarët e fuqizuar angazhohen në formimin e politikave, në ngritjen e të drejtave të reja, dhe në ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve për t'u përgjigjur dhe për t'u marrë në konsideratë prej tyre.¹⁰

Në mënyrë të veçantë, qytetaria e pavarur çon në përfshirjen e grave si subjekte dhe aktore politike të të drejtave të tyre – përtej roleve të tyre të atribuara nga shoqëria si nëna, bashkëshorte dhe bija.

Është e nevojshme që përpjekjet e vërteta dhe të qëndrueshme të bazohen në parimet e barazisë dhe drejtësisë gjinore, në mënyrë që, si gratë, ashtu edhe burrat, të gëzojnë të njëjtat të drejta si aktorë të ligjshëm politikë. Në praktikë, ata kanë nevojë t'i përkushtohen riformimit të kuadrit dhe mekanizmave socialë, ekonomikë, ligjorë dhe elektorale, të cilët mundësojnë proceset e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes aktive, të informuar dhe të qartë të grave në të gjitha sferat dhe në të gjitha nivelet.

¹⁰ Cornwall, A. and Gaventa, J. (2001) From users and choosers to makers and shapers: repositioning participation in social policy, IDS Working paper 127

Gratë në politikë dhe politika e burrave ¹¹

Martin Leka

Për ta thjeshtëzuar problemin, le t'i hedhim një vështrim imagjinar asaj çfarë ndodh rëndom me burrat, për gratë. Për marrëveshje fjale, askush nuk besoj të kundërshtojë faktin se për gratë (këtu nuk e kam fjalën në përkufizimin e ngushtë të bashkëshorteve të burrave, por në nocionin e përgjithshëm të seksit femër), të gjithë pranojnë se ato kanë dhe gëzojnë të drejta të barabarta, janë të zonjat po aq sa burrat, janë të zgjuara po kaq e në mos më shumë se burrat, janë oratore, punëtore, intelektuale, shkencëtare, shkrimtare, gazetare etj. etj., njësoj si dhe burrat. Po kaq dakort biem edhe me faktin se gratë, në disa cilësi specifike, ua kalojnë edhe burrave, siç fjala vjen, në ndjeshmërinë që ato kanë ndaj disa fenomeneve negative, në ndershëmërinë e punës e zbatimit e rregullit, në moskorrupsionin e lehtë të tyre, në mungesën e kompromisit të dëmshëm, etj. Në fund të fundit, po të pyesësh të gjithë burrat e botës, ndoshta jo vetëm për mirësjellje, të thonë se gratë janë “gjysma më e mirë!”.

Mirëpo nuk ndodh kështu në jetën politike. Gratë janë në minorancën më të vogël të mundshme. Mjafton t'i hedhim një sy panoramës politike në këto 14-15 vite demokraci, për të dalë në përfundime lidhur me pjesëmarrjen e mjerë të gruas në politikë. Statistikat mbi këtë fenomen nuk do t'i kishte zili as sistemi i kaluar, i cili edhe pse për “dekor”, mbliidhte pa kriter traktoriste, kooperativiste, brigadiere, tornitore, shofere, etj. dhe i vinte në detyra të rëndësishme të partisë së shtetit komunist. Partitë politike shqiptare ende sundohen nga mentaliteti maskilist, ku “burrat janë të lindur për politikë”. Edhe aq pak hapësirë sa ka

Partitë politike shqiptare ende sundohen nga mentaliteti maskilist, ku “burrat janë të lindur për politikë”. Edhe aq pak hapësirë sa ka në politikën e sotme pjesëmarrja e gruas, më shumë duket, ose në përpjekjet e vetë grave për të shfaqur aftësitë e tyre, ose në politikën e burrave për të futur në forume edhe disa gra, në përpjekje për të marë vota prej tyre.

¹¹ Botuar për herë të parë në gazetën “Shekulli”, datë 8 Mars 2005, faqe 14.

në politikën e sotme pjesëmarrja e gruas, më shumë duket, ose në përpjekjet e vetë grave për të shfaqur aftësitë e tyre, ose në politikën e burrave për të futur në forume edhe disa gra, në përpjekje për të marë vota prej tyre.

Një “guidë” e thjeshtë dhe e sipërfaqshme, tregon se në Parlamentin shqiptar me 141 deputetë, vetëm 9 janë gra; në qeveri e njëjta përqindje e ulët; në pozicionet drejtuese të partive gjithashtu. Niveli i ulët i pjesëmarrjes së grave në politikë, siç tregohet nga disa statistika të organizmave të vetë grave, është më i ulët se ai i viteve ‘20-të (?!). Nuk kemi ende asnjë kryetare partie, madje ende nuk është guxuar që një femër të kandidojë për një post të tillë në këto vite demokraci. Madje, edhe një përpjekje serioze për kandidim për kryetare të një partie me peshë jo të vogël përfaqësimi, u kalua fare në heshtje, jo vetëm nga “burrat e partisë”, por edhe nga media.

Partitë politike, të ndodhura ndoshta përpara trysnisë së opinionit të vetë grave, kanë arritur të deklarojnë publikisht, sidomos në prag fushatash, përqindje pjesëmarrjeje të detyrueshme të grave në politikë dhe vendimmarrje. Madje mesa di, dy partitë e mëdha, ajo socialiste dhe demokrate, i kanë përfshirë këto përqindje dhe në dokumentet e tyre zyrtare.

Por, për shkaqe të shumta, ky fenomen ende gjendet në shifra ndër më të ulëtat në Europë. Për të ndyshuar këtë pamje të zymtë të politikës, nuk mendoj se mjafton që gratë të mbeten në pritje të “mëshirës” së burrave të politikës për përqindjet që ato duhet të zënë. Nëse ndodh kështu do të kemi të njëjtën panoramë: Burrat që shkruajnë statistika në letër për pjesëmarrjen e grave në politikë dhe gra që vazhdojnë të “qahen” për të drejtat e tyre.

Për t’i dhënë kësaj panorame “gri” një pamje më “rozë”, do të duhet që organizatat që mbrojnë të drejtat e grave jo vetëm të konstatojnë “maskilizmin” e politikës shqiptare, por dhe të kenë guximin e marrjes së përgjegjësiive konkrete, pa pasur

frikën e mentalitetit, sipas të cilit, gratë refuzojnë pjesëmarrjen në politikë, pasi “nuk duan të përbalten e njollosen prej saj”. Nga ana tjetër, edhe burrat e politikës, duhet të kenë më shumë besim tek aftësitë e grave dhe jo të lexojnë (sa herë vijnë zgjedhjet) statistika standarte për pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje e politikë.

Partitë nuk duhet të harrojnë se çdo premtim për përqindjet që nuk janë realizuar, ka vlerën e një borxhi!

Gratë në politikë si cilësi e demokracisë ¹²

Eglantina Gjermeni

Statusi dhe pozicioni i grave në një shoqëri të caktuar varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga niveli i zhvillimit ekonomik dhe social si dhe niveli i demokracisë së saj. Ndërsa përgjithësisht këta dy dhjetëvjeçarët e fundit në të gjitha vendet e zhvilluara ka një ndjeshmëri të lartë ndaj barazisë gjinore në tërësi dhe asaj në vendimmarrje në veçanti, në Shqipëri akoma janë të paktë ata dhe ato që janë realisht të bindur se gratë i duhen politikës po aq sa burrat, dhe se e drejta e tyre për përfaqësim dhe pjesëmarrje nuk ka pse të jetë e ndryshme nga ajo e burrave.

Të gjitha masat që duhet të ndërmerren për të arritur barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, janë të paraqitura në mënyrë shumë të qartë në Platformën për Veprim të Pekinit, në Konventën për Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW) si dhe në dokumente e konferenca të ndryshme ndërkombëtare. Këto dokumente dhe aktivitete ndërkombëtare, kryesisht të Kombeve të Bashkuara, shërbejnë si bazë për zhvillimin e planeve të veprimit dhe platformave për arritjen e barazisë gjinore në vendet anëtare. Shqipëria bën pjesë në ato vende të cilat kanë ratifikuar këto konventa, dhe që në momentin e ratifikimit, i duhet të përmbushë të gjitha detyrimet përkatëse, qofshin këto lidhur me zbatimin e tyre apo raportimin lidhur me mënyrën e zbatimit. Udhëzimet që u jepen qeverive të vendeve të ndryshme në këto dokumenta prekin çështjet më kritike të pabarazive gjinore ekzistuese, duke përfshirë këtu: stereotipet dhe dhunën gjinore, pjesëmarrjen në jetën politike, trafikimin e prostitucionin, statusin ligjor, median, arsimin, kujdesin shëndetësor, varfërinë, mjedisin, jetën në zonat rurale, planifikimin familjar, martesën dhe marrëdhëniet

¹² Botuar për herë të parë në gazetën "Shekulli", datë 21 Maj 2005, faqe 14.

në familje.

Çështje të ndryshme të lidhura me barazinë gjinore nuk mund të trajtohen në mënyrë efikase, nëse nuk hidhen hapa në të gjitha fushat njëherazi.

Për shembull, përpjekjet për të përmirësuar të ardhurat e grave nuk mund të përqendrohen vetëm në përmirësimin e legjislacionit dhe në hartimin e politikave të reja në tregun e punës. Ato duhet të përfshijnë dallimet gjinore që ekzistojnë në arsimimin e grave dhe vajzave, ekspozimin ndaj dhunës, stereotipet gjinore ekzistuese, ndarjet e përgjegjësive mes grave dhe burrave brenda familjes, po kështu edhe çështje, të tilla si: politikat makroekonomike dhe shpërndarja e burimeve.

Meqenëse Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit konsiderohen si mjete për të riintensifikuar përpjekjet në përmbushjen e premtimeve globale, ajo që duhet bërë për të arritur Objektivin e Tretë "Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i gruas", është që të zbatohen Platforma për Veprim e Pekinit dhe Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas. Përmbushja e Objektivit të Tretë të Mijëvjeçarit, nuk mund të realizohet e shkëputur nga arritja e objektivave të tjerë. Për më tepër, përmbushja e Objektivit të Tretë të Mijëvjeçarit, mund të realizohet vetëm nëse hapat e ndërmarra në realizimin e Objektivave të tjera synojnë nxitjen dhe arritjen e Barazisë Gjinore.

Në këto kushte, sigurimi i pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje dhe politikë është thelbësor në arritjen e Objektivit të Tretë të Mijëvjeçarit edhe për shoqërinë shqiptare. Në kuadër të arritjes së këtij objektivi, një sërë vendesh kanë arritur tashmë nivele të mira të pjesëmarrjes së grave në sistemin vendimmarrës dhe politikë. Përvoja e tyre tregon se sistemi i kuotave për pjesëmarrjen e grave, ka bërë të mundur përfaqësimin e tyre në legjislacionet vendore dhe kombëtare. Për më tepër, një lëvizje e fuqishme e gruas dhe politikat qeveritare që lehtësojnë rolet e shumëfishta të saj, kanë nxitur dhe mbështetur pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje e

Çështje të ndryshme të lidhura me barazinë gjinore nuk mund të trajtohen në mënyrë efikase, nëse nuk hidhen hapa në të gjitha fushat njëherazi.

...pjesëmarrja e grave në nivelet vendimmarrëse, ka bërë të mundur që ato të ndikojnë drejtpërdrejtë në miratimin e ligjeve; nga hartimi dhe zbatimi i të cilëve do të mund të përfitojnë gratë, fëmijët dhe familjet në përgjithësi.

...pjesëmarrja e grave në institucionet vendimmarrëse përmirëson cilësinë e qeverisjes.

politikë.

Që në Konferencën e Katërt të Kombeve të Bashkuara dhe në Platformën për Veprim të Pekinit (1995) është rekomanduar që qeveritë të vendosin një kuotë prej 30 për qind të vendeve në parlament për gratë. Ky u konsiderua vetëm si hap i parë drejt arritjes së barazisë gjinore në vendimmarrje, sepse në fakt, barazia gjinore e plotë dhe fuqizimi i grave kërkon 50 për qind përfaqësim të grave në të gjitha nivelet vendimmarrëse. Disa nga argumentet që përforcojnë rëndësinë e kësaj pjesëmarrjeje janë:

Së pari, mundësitë e barabarta për pjesëmarrje në politikë janë çështje të të drejtave të njeriut. Vendet në të cilat gratë zënë më pak vende se sa 30 për qind në parlament, janë më pak përfshirëse, më pak të barabarta dhe më pak demokratike.

Së dyti, pjesëmarrja e barabartë është e rëndësishme, pasi bën të mundur që interesat e grave të pasqyrohen në mënyrë të qartë e të drejtë në të gjitha nivelet vendimmarrëse. Të dhënat tregojnë se pjesëmarrja e grave në nivelet vendimmarrëse, ka bërë të mundur që ato të ndikojnë drejtpërdrejtë në miratimin e ligjeve; nga hartimi dhe zbatimi i të cilëve do të mund të përfitojnë gratë, fëmijët dhe familjet në përgjithësi.

Së treti, nga të dhënat ekzistuese të përvojave në vende të ndryshme botërore, del në pah se pjesëmarrja e grave në institucionet vendimmarrëse përmirëson cilësinë e qeverisjes.

Në janar të vitit 2005, Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara botoi një raport mbi arritjen e Objektivit të Tretë të Mijëvjeçarit, raport i realizuar nga një grup ekspertësh të pavarur.¹³ Sipas këtij raporti, vetëm 14 vende kanë përmbushur objektivat e Platformës për Veprim të Pekinit që parashikonte si

¹³ Taking action: achieving gender equality and empowering women – Achieving the Millennium Development Goals. UN Millennium Project. Task Force on Education and Gender Equality. Janar 2005.

qëllim afatshkurtër arritjen e nivelit 30 për qind të pjesëmarrjes së grave në parlament. Këto vende janë: Argjentina, Bahamas, Belgjika, Kosta-Rika, Kuba, Danimarka, Finlanda, Islanda, Mozambiku, Holanda, Norvegjia, Ruanda, Afrika e Jugut dhe Suedia. Ndërkohë që në 27 vende të tjera, gratë përbëjnë 20-27 për qind të parlamentarëve. Megjithatë, gratë kanë bërë përparime në fushën politike përsa i përket periudhës 1990-2000. Nga 129 vende që kanë të dhëna për pjesëmarrjen në parlament, në 96 prej tyre, gratë kanë rritur përqindjen e përfaqësimit të tyre. Ndërkohë, ndërsa në 29 vende përqindja e grave në parlament është ulur, në 4 vende të tjera ajo ka mbetur e pandryshuar. Shqipëria bën pjesë në këto 29 vende, në të cilat pjesëmarrja e grave në parlament është ulur.

Megjithëse kuadri ligjor ekzistues dhe fakti që partitë politike të mëdha kanë përcaktuar në statutet e tyre përqindje për pjesëmarrjen e grave si kandidatë, fatkeqësisht rezulton se kjo përqindje nuk është respektuar dhe zbatuar nga asnjë prej partive në listat e kandidatëve.

Megjithëse kuadri ligjor ekzistues dhe fakti që partitë politike të mëdha kanë përcaktuar në statutet e tyre përqindje për pjesëmarrjen e grave si kandidatë, fatkeqësisht rezulton se kjo përqindje nuk është respektuar dhe zbatuar nga asnjë prej partive në listat e kandidatëve.

A është ky një kthim prapa? A do të vazhdojë Shqipëria të ketë tregues kaq të ulët të pjesëmarrjes së grave në sferën publike, konkretisht në vendimmarrjen politike? Vërtet do të mbetet pjesëmarrja e grave në parlamentin shqiptar në shifra të dhimbshme 5, 7 apo 6%? Nga listat e kandidatëve që kanë publikuar dy partitë e mëdha, rezulton se në listën e kandidatëve të Partisë Socialiste janë vetëm 8 kandidatë gra, ndërsa në listën e kandidatëve të Partisë Demokratike vetëm 3. Duke iu uruar sinqerisht fitoren e të gjitha kandidatëve gra dhe, duke supozuar fitoren e tyre, sërish përqindja e pjesëmarrjes së grave në parlament nuk mund të ndryshojë shumë. Atëherë kthehemi sërish tek nevoja për të vendosur sistemin e kuotave dhe vendeve të përcaktuara në Parlament, si një mekanizëm i domosdoshëm për të krijuar një mundësi pjesëmarrje të gjysmës së popullsisë, duke synuar një zhvillim të plotë, efikas dhe demokratik të një shoqërie.

Sërish, duke iu referuar të njëjtit raport të cituar më lart, mund të themi se vendosja e sistemit të kuotave ka rezultuar e suksesshme në një sërë vendesh për rritjen e pjesëmarrjes së grave në parlament. Megjithëse shumë vende kanë zbatuar sistemin e kuotave, nuk mund të thuhet se ai siguron plotësisht pjesëmarrjen e grave në politikëbërje. Në vitin 2004, 37 vende kanë vendosur sistemin e kuotave për gratë. Sistemet e kuotave janë përdorur në vende të varfëra dhe të pasura si dhe në vende me demokraci të vjetër apo të re. Përvoja e vendeve që kanë provuar sistemin e kuotave ka nxjerrë në pah katër mësim, në mënyrë që kuotat të bëhen më efektive dhe për të rritur zërin e grave në vendimmarrje e në politikë.

Së pari: Sistemi elektoral i një vendi, ndikon fuqishëm edhe sistemin e kuotave. Kuotat funksionojnë më mirë në listat të mbyllura, në sistemin përpjestimor me mandate të përcaktuara dhe ku zonat elektorale janë të mëdha. Në këtë sistem, votuesit votojnë për partinë, jo për kandidatët individualë, dhe udhëheqësit e partisë kontrollojnë vendosjen e kandidatëve në lista. Numri i votave që merr partia, vendos se sa kandidatë nga lista do të zgjidhen.

Së dyti: Vendosja e mandateve është thelbësore për suksesin e kuotave në listat e mbyllura përpjestimore të sistemit elektoral. Meqënëse kandidatët janë të zgjedhur nga lista e partive, vendosja në listë përcakton shanset për t'u zgjedhur ose jo. Dhënia e mandateve dhe vendosja në listë, kërkon nga partitë që të vendosin gratë në rradhët e para të listës për t'u dhënë mundësi që të zgjidhen. Ky sistem vendos një balancë të mirë mes grave kandidate dhe atyre që zgjidhen deputete.

Së treti: Ligjet e kuotave duhet të përfshijnë edhe detajet për zbatimin e tyre. Ligjet e papërcaktuara mirë u lënë shumë hapësirë partive politike për të zbatuar ose për të dështuar në zbatimin e sistemit të kuotave.

Së fundmi: Që kuotat të jenë efektive, duhet të ketë edhe

sanksione për moszbatimin e tyre. Sanksioni më i fortë konsiston në deklarimin e listës së kandidatëve të partisë si të paaftë dhe partia të ndalohet që të kontestojë zgjedhjet.

Prezenca e një lëvizjeje të fuqishme politike mund të sjellë një ndryshim në rritjen e përfaqësimit të grave në vendimmarrje. Mbase mund të duket se tani jemi shumë vonë për ta ndryshuar situatën për këto zgjedhje nga të cilat na ndan pak më shumë se një muaj, por mbetet shumë për të bërë pasi zgjedhjet vendore janë vitin e ardhshëm.

Organizatat e grave dhe gjithë shoqëria civile mund të koordinojnë përpjekjet e tyre dhe t'u ushtrojnë presion qeverisë dhe partive politike, në realizimin e angazhimeve të marra në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Organizatat e grave dhe gjithë shoqëria civile mund të koordinojnë përpjekjet e tyre dhe t'u ushtrojnë presion qeverisë dhe partive politike, në realizimin e angazhimeve të marra në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Aromë gruaje¹⁴

Zefina Hasani

Z. Nano zgjodhi Valentina Leskaj-n për partinë rozë. Por, edhe Z. Berisha ka zgjedhur Majlinda Bregu-n. Ndërsa Z. Gjinushi shkrintaren Diana Çuli. Sepse gratë e ardhura nga OJF-të, dinë të bëjnë reforma. Si po ndryshon imazhi i politikës shqiptare? Politikanet e reja rrëfejnë misionin e tyre.

Eveshur me një palë geta rrjete, me një bluzë në ngjyrë të ndezur me një fjongo të madhe në jakë dhe me një fund mjaft 'trendy', me flokët e shpupurisura, sipas krehjes moderne të këtyre kohëve. Kështu është shfaqur Majlinda Bregu në prezatimin e saj të parë, në një emision televiziv, pak ditë pasi kishte pranuar ftesën e Z. Sali Berisha, për të hyrë në Komitetin e Orientimit të Politikave, pranë Partisë Demokratike. Ndoshta shumëkush mund të ketë menduar se do të ishte më 'serioze' që ajo të shfaqej me ndonjë kostum zyrtar, ashtu siç i ka hije një gruaje të tashmë do të merret me politikë. Por, Majlinda Bregu zgjodhi enkas atë imazh tjetër për të sfiduar që në fillim të angazhimit të saj të ri, imazhin mashkullor që ka pushtuar politikën shqiptare. Një mision që, në fakt ajo e ka kryer që në kohët kur nisi angazhimet me organizatat e ndryshme joqeveritare, që mbrojnë të drejtat e femrave, pa e ditur se pikërisht për këtë kontribut që kishte dhënë, do ta tërhiqnin drejt dyerve të politikës.

Ndërkohë, të njëjtën rrjedhë ka marrë edhe jeta e Diana Çulit. Prej shumë vitesh presidente e Forumit të Gruas Shqiptare, tani Diana Çuli do të shfaqet dhe si një personazh i ri

¹⁴ Botuar më parë në revistën "Klan", datë 19 Mars 2005, faqe 22-24.

në jetën politike. Z. Skënder Gjinushi e ka ftuar të bëhet pjesë e partisë së tij dhe ajo ka pranuar, duke marrë përsipër të njëjtën sfidë si Majlida Bregu për Partinë Demokratike: ***përmirësimin e imazhit femëror në politikën shqiptare.***

Frugën e kanë të hapur. I kanë zgjedhur pikërisht pse ato janë femra të suksesshme, luftarake në mbrojtjen e ideve të tyre dhe, mbi të gjitha, me një përvojë disa vjeçare në jetën publike. Drejtuesit e partive kanë dhe një shembull konkret, si një garanci të mirë për zgjedhjen që kanë bërë.

Vetëm pak kohë më parë, kreu i Partisë Socialiste, Z. Fatos Nano, kishte zgjedhur prej radhëve të grave të njohura, përfaqësuese të OJF-ve, që kanë treguar se dinë të bëjnë reforma, pikërisht Zonjën Valentina Leskaj. Mesa duket, Leskaj e ka pasur këmbën e mbarë, përderisa brenda fare pak kohësh tërhoqi në politikë dhe dy zonja të tjera.

Është fakt që i gëzon të trija koleget. *Për to nuk ka aspak rëndësi që nuk do jenë më si një herë e një kohë pjesëtare të së njëjtës organizate gruaje, por të partive rivale.* Secila prej tyre e di se në çfarë karrige që të ulen, do të dinë të kryejnë ashtu siç duhet misionin, atë mision që në fillim nisën të kryenin nga të njëjtat pozita, ndërsa tani nga pozita të kundërta. Ndoshta pas pak kohësh edhe nga salla e Parlamentit Shqiptar, kur ato të jenë dhe deputete gjithçka mund të ndodhë. Pse jo, përderisa ndodhi dhe me Valentina Leskajn.

Shembulli Leskaj nuk u ka shërbyer vetëm krerëve të partive. U ka vlejtur dhe dy personazheve të reja, për të kuptuar se nuk është dhe aq e lehtë për të çarë në botën mashkullore të politikës. Valentina Leskaj tregon se dita e parë në Parlament ka qenë shumë tronditëse për të. *“Kur një grua vendos të bëhet pjesë e Parlamentit, duhet të ndihet e mirëseardhur, gjë që unë nuk e ndieva ditën kur shkela për herë të parë në sallën e Parlamentit”.* Ndoshta mund të kishin menduar se kjo grua nuk ishte aq e pjekur politikisht, për të qenë pjesë e atij parlamenti.

Frugën e kanë të hapur. I kanë zgjedhur pikërisht pse ato janë femra të suksesshme, luftarake në mbrojtjen e ideve të tyre dhe, mbi të gjitha, me një përvojë disa vjeçare në jetën publike. Drejtuesit e partive kanë dhe një shembull konkret, si një garanci të mirë për zgjedhjen që kanë bërë.

Megjithatë, Z. Nano ka qenë i bindur për të kundërtën, përderisa e emëroi Ministre të Punës dhe Çështjeve Sociale, e shpalli dhe deputete kur ajo ende nuk kishte marrë taserën e partisë. *“Taserën e mora shumë kohë më pas”*, sqaron vetë Leskaj, “sepse nuk e ndieja te nevojshme. Unë nuk kisha nevojë për këtë ‘kartë krediti’, për të hyrë në politikë”.

E kishte fituar krejt ndryshe këtë të drejtë, duke investuar për vite me rradhë në problemet shoqërore civile, që në vitin e parë të demokracisë kur së bashku me disa kolege të tjera krijoi shoqatën e parë joqeveritare, “Forumit e Pavarur të Gruas”. I është dashur që në fillim të njihet me ligjet, me politikën e shtetit, për të ditur të mbrojtë e të zgjidhë problemet e ndryshme sociale. “Puna me ligjet dhe me njerëzit në nevojë të jep padashje pjekurinë politike”.

Ndonëse ajo nuk e kishte menduar kurrë se për këtë pjekuri do ta kërkonin të bëhej pjesë e një force politike. *“Kisha vite që bëja përpjekje që numri i grave në Parlament të rritej, por pa e llogaritur kurrë veten. Ndaj kur Z. Nano më bëri ftesën, kisha nevojë të reflektoja”*. Në fund e pranoi postin e ministres, e bindur se pasi kishte dhënë për shumë vite kontribut në jetën shoqërore, duhej të jepte edhe në politikë. Edhe pse e dinte se nuk do kishte aspak të lehtë.

Ashtu si Majlinda Bregu edhe ajo hyri me qëllimin për të futur modelin e saj prej femre në politikë. *“U përballa me një agresivitet, sidomos kur provon dhe një fushatë elektorale, që s’është shumë kohë të veprosh sipas filozofisë tënde”*. Megjithatë, ajo nuk e tradhëtoi filozofinë e saj.

Iu desh vetëm të modifikonte disi modelin e gruas, që ishte mësuar të shkonte nëpër rrethe të ndryshme të Shqipërisë për probleme të ndryshme, duke u përshtatur me një fjalor më politik (të cilin mendon se duhet ta pasurojë ende). Ky ishte i vetmi ndryshim që ajo ndjeu në fushatën e saj të parë elektorale në Elbasan. Pjesa tjetër ishte njesoj, si më parë: do të hynte shtëpi më shtëpi, do të diskutonte problemet që kishin familjarët e do të merrte përsipër zgjidhjen e tyre. Nuk kishte bërë më pak edhe kur ishte në Forumit e Gruas. Pra, Valentina

Leskaj nuk ka hyrë krejt papritur në politikë, siç mund ta kenë menduar të tjerët. *“Një lloj politike e ka bërë edhe duke qenë në forum”*. Mirëpo, në atë politikën jashtë dyerve të partisë e ka ndier veten më të lirë. Ndërsa, politika që e ka bërë të njohur (për një vit e gjysmë) si ministre, si deputete e së fundmi si Sekretare e Marrëdhënieve me Publikun në Partinë Socialiste, e ka privuar nga shumë gjëra.

Ka qenë pikërisht frika se mos politika di t’ia ngushtojë lirinë dhe kohën e krijimtarisë, që e ka bërë Diana Çuli të mendohet gjatë për ftesën që Z. Skënder Gjinushi i bëri pak kohë më parë. Asnjëherë në vitet e komunizmit nuk kishte rënë pre e kërkesave për t’u bërë anëtare e Partisë së Punës. Kishte ndjekur gjithnjë punën e saj si redaktore në gazetën “Drita” dhe më pas në revistën “Les lettres Albanias” (Letrat Shqipe), pa pretenduar poste drejtuese. Mjaftohej me emrin që po bënte si shkrimtare dhe me punën komode që kishte. Pastaj përmbysja e demokracisë do t’ia përmbyste dhe asaj këtë regjim jete. Menjherë në vitet ’90-të, Diana Çuli nisi të angazhohej me lëvizjen e gruas, me Forumin e Pavarur dhe në vitin 1991 u zgjodh si presidente e këtij forumi.

Por, ashtu si dhe më parë, shkrimtarja do të vazhdonte t’i qëndronte larg ftesave për të hyrë në politikë. “Kohën time e kam konsideruar gjithnjë shumë të shenjtë, ndaj dhe kur pranova të bëhem presidente e Forumit të Pavarur të Gruas, pata frikë se po hyja drejt një angazhimi që do të më sillte shumë detyrime. Me kohë arrita të vendos një regjim të ri. Më tërhoqi puna me problemet e gruas dhe hyrja dashje pa dashje në një politikë, në mbrojtje të tyre.”

I dukej se po njihte një botë të re. Kishte shkuar dhe më parë nëpër krahina të ndryshme të Shqipërisë, por si gazetarë kulture, ndërsa tani si presidente e Forumit të Pavarur të Gruas, do t’i duhej ta njihte ndryshe botën, të dallonte se çfarë ishte pushteti lokal nga ai qendror, të njihej me politikanët që do t’i jepnin ndihmën e duhur për zgjidhjen e problemeve, të mësonte të krijonte lobing për të mbrojtur idetë e saj....një përvojë e

“Nuk është se po e mendoja angazhimin tim në politikë, por me miq dhe kolegë bisedonim që ishte gabim që gratë që vijnë nga shoqëria civile të mos bëhen vendimmarrëse, të mos hyjnë në Parlament”.

gjatë që e lidhi edhe më fortë me politikën. Megjithatë, mbetej një lidhje e sipërfaqshme, deri në ditën kur Z. Gjinushi e ftoi të hynte në radhët e partisë së tij. *“Vendosa të bëj një sfidë të tillë, edhe pse nuk e pata aspak të lehtë”.*

Ndjeu se ishte pikërisht kjo koha e duhur. *“Nuk është se po e mendoja angazhimin tim në politikë, por me miq dhe kolegë bisedonim që ishte gabim që gratë që vijnë nga shoqëria civile të mos bëhen vendimmarrëse, të mos hyjnë në Parlament”.*

Gjithsesi, kur një ftesë konkrete i trokiti në derë, s'ishte gati të thoshte po. Ndoshta, pse e dinte se do t'i duhej sërish të bënte ndryshime rrënjësore në jetën e saj, si 15 vjet më parë kur mori në duar drejtimin e Forumit të Pavarur të Gruas. *“Nuk ishte vetëm kjo që më bënte të hezitohja, por edhe frika se mos më kufizohej liria. E megjithatë, tani nuk e kam pse të flas më për të tilla gjëra, përderisa i kam thënë ‘po’ ftesës.”* Pranoi të majtët, sepse ndihet më pranë parimeve të saj. Nuk i dihet nëse do të kishte pranuar ftesë nga ndonjë krah tjetër. Di të thotë se nuk është penduar për zgjedhjen që ka bërë dhe se do të kujdeset që ta ruajë me çdo kusht nga privimet që të jep të qenit brenda në politikë dhe nga ndryshimet që të dikton një angazhim i tillë. Edhe nëse një ditë do ta shohim të ulet në Parlament, deputetja Diana Çuli, do të dijë të ruajë të paprekur imazhin e saj të formuar në kohë, si shkrimtarja dhe presidentja e një Forumi. Do të dijë të shijojë liritë e saj, pse jo, dhe për të kthyer me qejf një gotë tekila në një festë mes miqsh. Një model i ri, modern, deputeteje që do t'i kishte hije Parlamentit.

Ashtu siç nuk mund të quhet më çudi nëse në ditë edhe Majlinda Bregun mund të shohim në fushatën elektorale, e më pas edhe në parlament. Ajo vetë nuk e mendon, por ndoshta ata që e ftuan të hyjnë në Komitetin e Orientimit të Politikave po mendojnë ta kenë dhe deputete në ndonjë zonë të Partisë Demokratike. *“Unë nuk dua të parashikoj, por të punoj”*- ta pret shkurt ajo vetë. Tani për tani ajo është një nga gjashtë personazhet femra të KOP-it, e zgjedhur si eksperte nga fusha

e çështjeve sociale. Por, nëse i vjen një ftesë e tillë, nuk ka pse të çuditet, ashtu siç nuk u çudit kur erdhi ftesa e parë e Z. Berisha.

“Unë nuk jam fshehur asnjëherë në prononcimet që kam bërë për çështjet e ndryshme që më janë dukur që nuk shkojnë ashtu siç duhet, ndaj m’u duk normale që dikush më kërkoi që deklaramet e bëra nëpër mediat e ndryshme t’i orientoja në KOP”.

Majlinda Bregu është e bindur që kanë qenë pikërisht faqet mediatike që e kanë bërë më të dukshme. *“Sapo përfundova studimet në Fakultetin e Shkencave Sociale, jam angazhuar prej kohësh në organizata të ndryshme jo qeveritare, por më së shumti me Qendrën Aleanca Gjinore për Zhvillim. Roli im kryesor ka qenë ai i ndërmjetësues mes këtyre qendrave dhe medias lidhur, me probleme të ndryshme.”*

Një rol të tillë do të kryejë dhe tani që ka hyrë në KOP, vetëm se ndërmjetësimi këtë herë drejtohet jo në media, por në selinë e PD-së.

“Mund të kishte qenë edhe ndonjë parti tjetër. Çfarëdo lloj force që do të kishte pushtet, nëse gjërat do të ishin kaq keq sa janë, unë do të isha në pozicionin e kritikut”.

Është pikërisht ky lloj pozicioni i propozuar që e ka joshur të hyjë në politikë, të nisë të studiojë ligjet njëri pas tjetrit, të gjitha strategjitë, e të punojë në terren, që të mund të japë mendimet e saj lidhur me zgjedhjet e mundshme. Nuk i duket e lodhshme kjo lloj pune, të cilën, në një farë mënyre ka vite që e kryen; për një dokumentar televiziv, për një studim, për ndonjë trajnim në rrethe të ndryshme të Shqipërisë apo për ndonjë projekt të Qendrës “Aleanca Gjinore për Zhvillim”. E duke kryer të gjitha këto detyra, ajo ka arritur të ndjekë edhe zhvillimet politike të vendit. Ndaj, asgjë nuk i dukej e panjohur kur nisi punën si anëtare e KOP-it. Ajo që ka filluar ta lodhë disi është

*“Më çudit fakti që
bëhesh interesante
vetëm në momentin
kur vesh një tis
politik. Për aq kohë
sa je jashtë saj,
profesionalizmi yt
mbetet në hije”.*

mënyra sesi njerëzit kanë filluar ta shohin.

“Më çudit fakti që bëhesh interesante vetëm në momentin kur vesh një tis politik. Për aq kohë sa je jashtë saj, profesionalizmi yt mbetet në hije”.

Vajzën që dikur njihej si folëse në edicionet kryesore të lajmeve në TVSH, e më pas si gazetare të dokumentarëve të ndryshëm televizivë, deri në ditën kur deklaroi se do të ishte anëtare e KOP-it, mediat nuk do ta monitoronin kaq shumë, tashmë si një figurë e re e politikës

Universitetet: Vendimet merren nga burrat ¹⁵

Elda Spaho

Asnjë rektore femër! Mes 37 dekanëve që numërohen në Shqipëri, vetëm 5 janë femra. Shifrat më të reja, botuar tani së fundmi në një raport të PNUD-it, “Politikat dhe zhvillimi në dobi të të varfërve dhe grave në Shqipëri”, janë të prera dhe flasin qartë: shumë pak femra arrijnë të ngjisin shkallët në strukturat drejtuese të universiteteve shqiptare. Ndryshon puna kur bëhet fjalë për mësimdhënien: 43% e pedagogëve në Shqipëri, sipas INSTAT, janë gra.

Për t’u bërë shefe departamenti, dekane e më pas rektore, duhen specializime, botime, grada. E nëse gjatë studimeve të larta, sipas të gjitha shifrave që kanë publikuar Ministria e Arsimit apo vetë universitetet, vajzat dalin me rezultatet më të larta se djemtë; të dhënat ndryshojnë kur vjen puna tek kualifikimet e tek karriera.

Përse nuk bën dot karrierë një femër në universitet?

Përgjigjet i japin vetë burrat, të martuar me gra që dikur kanë mbaruar studimet e larta dhe sigurisht kanë dashur të bëjnë karrierë. Por, që pas martesë, ia kanë lënë radhën burrit. “Jam munduar që në strukturat vendimmarrëse të universitetit që drejtoj, të respektoj ekuilibrin mashkull –femër. Kështu, nga 6 dekanë, 2 janë femra këtë vit, njëra e saporekomanduar prej meje. Por, gratë e kanë të vështirë t’i përkushtohen plotësisht hapave për t’u ngjitur lart. Kërkohen kualifikime, specializime, gjëra për të cilat ato shpesh nuk munden. Të

¹⁵ Botuar për herë të parë në gazetën “Shekulli”, datë 22 Mars 2005, faqe 9.

...femrat janë më korrekte se meshkujt në punë dhe se e marrin punën më seriozisht. "S'më kanë kërkuar kurrë t'u bëj lëshime në punë dhe nuk më është dashur kurrë ta bëj një gjë të tillë. Përkundrazi kanë qenë tepër të rregullta dhe më korrekte se burrat, unë i quaj amvisat e universitetit".

"Gratë janë të afta, por kur ato martohen, u ngarkohen mbi supe shumë staturë: ai i gruas, shtëpiakes, nënës dhe punës në fakultet. Kurse burrat shqiptarë janë më të lirë dhe nëse bëjnë karrierë, këtë ua detyrojnë zakonisht bashkëshorteve të tyre"

gjitha femrat drejtuese në Universitetin tim, 2 dekane dhe 6 shefe departamentesh, janë gra të martuara. Atyre u duhet të jenë njëkohësisht nëna dhe gra shtëpiake. Këto janë arsye të forta që i detyrojnë gratë të mos bëjnë karrierë në universitet, jo për shkak se u mungojnë aftësitë", - thotë rektori i Universitetit të Shkodrës, Z. Miri Hoti.

Pasi numëron departamentet që drejtohen prej grave në Shkodër (gjuhët e huaja, matematika, historia, ekonomiku, juridiku etj.), Hoti shton se femrat janë më korrekte se meshkujt në punë dhe se e marrin punën më seriozisht. "S'më kanë kërkuar kurrë t'u bëj lëshime në punë dhe nuk më është dashur kurrë ta bëj një gjë të tillë. Përkundrazi kanë qenë tepër të rregullta dhe më korrekte se burrat, unë i quaj amvisat e universitetit".

Drejtorit të Arsimit të Lartë, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, i duhet të pranojë se në strukturat vendimmarrëse të 11 shkollave të larta shqiptare femrat janë shumë të pakta. "Gratë janë të afta, por kur ato martohen, u ngarkohen mbi supe shumë staturë: ai i gruas, shtëpiakes, nënës dhe punës në fakultet. Kurse burrat shqiptarë janë më të lirë dhe nëse bëjnë karrierë, këtë ua detyrojnë zakonisht bashkëshorteve të tyre", - thotë Z. Agim Muçaj.

Në fakt, karriera e vështirë e femrave në universitet nuk është problem vetëm në Shqipëri. Rektori Hoti kujton një histori të jo shumë viteve më parë, në Frankfurt të Gjermanisë. "Gjatë një konference, u njoha me një profesoreshë shumë të përgatitur. Gjatë bisedës, më tregoi se nuk ishte martuar kurrë dhe se nuk kishte fëmijë. 'Nuk do ta kisha marrë gradën shkencore të profesoreshës nëse do t'i kisha bërë këto. Nuk do të më kishte mbetur kohë', më tha ajo", - tregon Z. Miri Hoti.

Megjithatë, ka gra që ia dalin mbanë. Por, siç duket sheshit, u duhet të punojnë shumë më tepër se burrat. Por, Muçaj thotë i bindur se nëse ka femra në strukturat drejtuese të universiteteve shqiptare, nuk ka pikë dyshimi se e kanë merituar

atë post. “Janë zgjedhur ato që i kanë plotësuar dhe i plotësojnë kriteret, nuk ka pasur dhe nuk do të ketë asgjë lehtësuese.”

Tabela 1: Ndarja gjinore e rektorëve, dekanëve dhe shefave të departamenteve në universitetet e Shqipërisë për vitin akademik 2003-2004:¹⁶

Nr	Universitetet	Rektorë		Dekanë		Shefa departamenti	
		Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
1	Universiteti i Tiranës	1	0	7	0	44	10
2	Universiteti Politeknik	1	0	4	0	21	4
3	Universiteti Bujqësor	1	0	3	0	12	3
4	Universiteti Elbasan	1	0	5	2	12	3
5	Universiteti Shkodër	1	0	6	1	14	6
6	Universiteti Korçë	1	0	3	1	6	5
7	Universiteti Gjirokastrë	1	0	3	0	9	1
8	Universiteti Vlorë	1	0	3	1	8	4
9	Akademia e Arteve	1	0	3	0	5	1
10	Akademia e Fiskulturës	1	0	0	0	4	0
11	Shkolla e Lartë e Infermierisë	1	0	0	0	1	1
Gjithsej		11	0	37	5	136	38

¹⁶ INSTAT, Femra dhe meshkuj në Shqipëri, Tiranë 2003, f. 42.

Pse lihet mënjanë gruaja nga vendimmarrja?!¹⁷

Lavdie Ruci

Në prag fushatash elektorale, krahasuar me rrjedhën e zakonshme të gjërave, ka gjithmonë një ndjeshmëri më të madhe edhe ndaj përfaqësimit të gruas në vendimmarrje. Kjo ndodh në mjedise femërore e mashkullore; të parat me dëshirën apo këmbënguljen për të çarë në politikë, të dytët të shqetësuar, nëse duhet t'u lëshojnë grave vendet fitimprurëse.

Problemi qëndron në mënyrën se si afishohet problemi nga të dyja palët. Duhet të kemi gra në politikë për hir të modës botërore apo europiane, apo se ato, duke përbërë gjysmën e zgjedhësve, mbartin të drejta dhe përgjegjësi njerëzore për të zgjidhur dhe për të përfaqësuar interesat e grupit të tyre shoqëror. Ngado që të hedhësh vështrimin, do të ndeshësh zhgënjim dhe shpërfillje për gruan, në një mjedis që sponsorizon në dukje tolerancë dhe hapje ndaj ndryshimeve, ndërsa në thelb ruan frikën ndaj çdo ekuilibri të ri social lidhur me barazinë gjinore. Për më tepër, niveli kulturor e arsimor i gruas në Shqipëri nuk ka diferenca krahasuar me burrin. Ndaj dhe është e pafalshme për partitë politike, ashtu edhe për lëvizjen politike të gruas, një pjesëmarrje e ulët dhe diskriminuere e grave në Parlamentin e Shqipërisë dhe në shumë poste të rëndësishme, rezervuar vetëm për klanin mashkullor.

Duke kërkuar faktorët që e çnatyrojnë këtë përfaqësim, shpesh rreshtohen arsye nga më të ndryshmet, që nga lufta e ashpër politike në Shqipëri, mungesa e interesit nga vetë gratë, mungesa e lobimit, jeta familjare që rëndon vetëm mbi gruan për shkak të ndarjes së pabarabartë gjinore të punës, deri tek

¹⁷ Botuar për herë të parë në gazetën "Korrieri", datë 20 Maj 2005, faqe 19.

pengesat artificiale prej grave të politikës për të rejtat që duan të hyjnë në të, apo mungesa e besimit për gratë politikane në zgjidhjen e problemeve.

Pavarësisht nga këto arsytetime të drejta, në Shqipëri vështirësohet pjesëmarrja e gruas në politikë, nga barrierat mashkullore, pasi me njëri - tjetrin “manovrojnë” më mirë në zhvillimin e bizneseve që u sigurojnë përfitime ekonomike. E nëse ka gra që mund të hyjnë në këto pazare, atyre u hapet rruga e bëhen palë. Jo më kot ka dalë shprehja që kur gratë merren me politikë, sillen si burrat. Kjo është e kuptueshme, pasi në politikë kemi modele burrash të suksesshëm, prandaj dhe tentohet që ata imitohen.

Një element tjetër që pëshpëritet, madje u ngrit edhe në një tryezë të rrumbullakët para tri javësh, është protagonizmi i një grushti grash në të gjitha kahet politike, që pasi arrijnë në pozicione të larta vendimmarrëse, nuk lejojnë të avitet kush tjetër duke monopolizuar karriken, presidiumin, publikun. Dhe shpesh thashethemnaja e tyre është më e rrezikshme se opinionet maskiliste të një tufe burrash kanunorë me kravata e kostume perëndimore, se marrin rolin e kompetentit në çështjet e gruas. Por, këto s’mund të jenë thjesht çështje burrash a grash, por çështje dinjiteti dhe zhvillimi demokratik të të gjithë shoqërisë.

Në të vërtetë, duhet të ndodhte e kundërta. Gratë, duke njohur njëra – tjetrën, mund të promovojnë vlerat, formimin kulturor e profesional të sho-shoqes me natyrshmëri, me këmbëngulje, me përkushtim.

Nuk duhet harruar se duke njollosur dikë, diçka do të të bjerë në fytyrë edhe ty, kushdoqofsh! E keqja është se nga kjo mungesë lobimi midis grave, përfitojnë burrat e politikës, duke shtrënguar fort radhët e tyre në pozicionet vendimmarrëse. Vetëm pasi të zgjidhim këtë nyje, mund të ecim më tej. Gruaja duhet të jetë protagoniste në politikë, jo thjesht për faktin se përbën gjysmën e popullsisë e të zgjedhësve, por është e drejta e saj të marrë pjesë në marrjen e vendimeve për grupin shoqëror

Gratë, duke njohur njëra – tjetrën, mund të promovojnë vlerat, formimin kulturor e profesional të sho-shoqes me natyrshmëri, me këmbëngulje, me përkushtim.

që përfaqëson. Ajo është më pranë problemeve shoqërore, të familjes, fëmijëve, të moshuarve. Prandaj, këto shqetësime e probleme duhen rregulluar ligjërisht që të mos jenë më të tilla, por të zgjidhen në mënyrë të efektshme për të mirën e gjithëve. Kush më mirë se gruaja mund të ndiejë, të sugjerojë dhe të vlerësojë shqetësime të tilla?!

Ky handicap shqiptar mund të zgjidhet vetëm me përfshirjen e sistemit të kuotimit, i cili fatmirësisht zbatohet për strukturat partiake në dy partitë më të mëdha politike, por jo në kandidimet për në parlament apo pushtetin vendor. Edhe në fushatën zgjedhore të porsanisur, gratë nuk po konkurojnë dukshëm siç shpresohet, edhe pas ndërgjegjësimit të bërë përmes përpjekjeve të organizatave të grave. Do të vlerësonim faktin që Partia Socialiste në listën proporcionale ka rreshtuar 20 gra në krye, të cilat mund të ndryshojnë përqindjen e përfaqësimit të gruas për këtë forcë.

Shkaqet janë ato që renditëm më lart dhe mund të shmagen me bashkëpunimin e të dy palëve, burrave dhe grave, për ta demokratizuar vërtet politikën shqiptare. Dhe këtu s'ka nevojë për shpikje. Po t'i drejtohemi përvojës botërore, vërejmë që përmes masave konkrete, shtetet e tjera deri në kufijtë tanë, kanë rritur pjesëmarrjen e gruas në vendimmarrje. Po ashtu gjithnjë e më shumë roli i grave vlerësohet në fushën sociale, si ndërmjetëse në zgjidhjen e situatave në konflikt, në marrëdhëniet ndërkombëtare e publike (në SHBA këto poste drejtohen nga gratë, ndërsa në parlamentet e Europës Veriore gratë zënë 40% të të zgjedhurve).

Politika shqiptare mjaft e përfolur, do të zbutet e qartësohet nëse partitë e ndryshme politike do të zëvendësojnë "politikanët" që nuk iu dëgjua zëri apo veprat gjatë tetë viteve në vendimmarrje me gra të shkolluara e të kualifikuara që e kanë treguar aftësinë në punët e detyrat që kanë kryer. Është e çuditshme që kryesitë e partive politike të lejojnë këtë mospërfillje të gruas në këto momente, kur e gjithë bota punon intensivisht për pjesëmarrjen gjithnjë e më të gjerë të grave në

vendimmarrjen politike.

Ndërkohë, media qëndron indiferente në këtë fushë, në vend që të nxisë pozitivisht. Fakti që edhe në emisionet e drejtuara nga gazetare gra, prezantojnë problemet vetëm ekspertë burra dhe asnjë grua, është dëshmi e qartë e një shoqërie maskiliste që nuk bën asnjë përpjekje për t'u moderuar a liberalizuar. Duket sikur gjithçka e thënë deri tani ka qenë thjesht demagogji apo sofizëm i kulluar. As njëra, as tjetra nuk e shpien botën përpara...!

Ëmbëlsi kompromentuese! ¹⁸

Kristi Pinderi

Gratë shqiptare dinë si të administrojnë paratë, ato bëjnë mrekulli me buxhetin e vogël familjar dhe largojnë të gjitha pasojat e varfërisë, e megjithatë, ato nuk kanë të drejtën e vendimmarrjes në institucione qendrore.

Ndërsa legjislacionet e ish-Kuvendit Popullor në regjimin komunist si dhe ish-Byroja politike, ishin të mbushura me anëtare femra, institucionet vendimmarrëse të 14 viteve të fundit në Shqipëri kanë qenë “bastione” të meshkujve. Në Kuvendin aktual, vendet që zënë femrat deputete numërohen me gishtat e dorës, ndërsa postet ministrore në qeveri janë akoma më të pakta. Një situatë e tillë paraqitet edhe në nivel lokal. Kjo pasqyrë të duket zhgënjyese, sidomos kur mendon që vitet që po jetojmë, janë vitet kulmore të kërkesave për barazi gjinore.

Gratë shqiptare dinë si të administrojnë paratë, ato bëjnë mrekulli me buxhetin e vogël familjar dhe largojnë të gjitha pasojat e varfërisë, e megjithatë, ato nuk kanë të drejtën e vendimmarrjes në institucione qendrore. Gratë janë të arsimuara më shumë se burrat, kanë një nivel komunikimi më të sigurt, e megjithatë prania e tyre në politikë është gati e papërfillshme.

Problemet janë të shumta edhe për ato pak gra që tentojnë të hyjnë në jetën politike dhe të zënë poste vendimmarrëse. Shumë gra e kanë të vështirë të konkurojnë kundër burrave. Si kandidatet femër, gjëja më e vështirë është të arrish të komunikosh me elektoratin tënd. Sfida për gratë, është të sigurojnë marrëdhëniet e duhura me publikun, kandidimin nga partitë e tyre dhe kohën e nevojshme në publik e në media për të prezantuar veten. Mirëpo, në Shqipëri, burrat kanë më tepër përvojë se gratë në jetën politike, ata e paraqesin veten ndryshe dhe janë shumë më tepër të mësuar

¹⁸ Botuar për herë të parë në revistën e përjavshme “Kult”, datë 30 Mars 2005, faqe 1.

në publik. Burrat përdorin një gjuhë më të fortë dhe e vendosin veten në qendër të vëmendjes (dëgjoni me vëmendje fjalimet gjatë një mitingu elektorali!). Nga ana e tyre, gratë nuk i fryjnë situatat, ato kanë tendencën për t'i qetësuar ato. Në fshat ka një panoramë edhe më pesimiste se kjo. Duket se gratë atje ende “preferojnë” të votojnë për një burrë, ose votojnë sipas dëshirës së bashkëshortit të tyre. Si në të gjitha vendet ballkanike, edhe në Shqipëri njerëzit i kushtojnë shumë më tepër vëmendje paraqitjes së një gruaje në publik se sa të një burri. Kjo do të thotë se një grua duhet të punojë tre herë më tepër se një burrë për të arritur të njëjtin rezultat. Të gjithë e dimë se vitet e fundit ke një “bonus” shumë të lartë dhe të sigurt, nëse hyn në politikë nga bota e biznesit. Po si mund të ndodhë kjo gjë me gratë, kur dihet se sa pak gra në biznes ka Shqipëria?!

Politikanët e të gjitha partive premtojnë një numër më të madh kandidatësh femra për zgjedhjet e ardhshme! Kjo është premtuese, por shikoni se çfarë argumenti sjellin ata për një domosdoshmëri të tillë: “na duhen gratë në politikë sepse sjellin një ëmbëlsi dhe e zbusin klimën konfliktuale!” Kjo do të thotë se gratë duhet të hyjnë në politikë, por vetëm për të zbutur klimën konfliktuale! Kjo përjashton gjykimin e drejtë sipas vlerave që ka secila, vlera që nuk kanë të bëjnë (të paktën në politikë) më të qenit grua. Në fund të fundit, “ëmbëlsia” që u kërkohet atyre, i përjashton nga e drejta për të marrë vendime duke i kufizuar në “detyrën” për të zbutur klimën! A nuk është kjo komprometuese?

Gratë janë të arsimuara më shumë se burrat, kanë një nivel komunikimi më të sigurt, e megjithatë prania e tyre në politikë është gati e papërfillshme.

6.4, 30 apo X %?! ¹⁹

Ermira Danaj

Në fakt, ka kohë që mendoj të shkruaj diçka për përfaqësimin e gruas në vendimmarrje. Gjithnjë më dukej sikur shumë ishte thënë tashmë, dhe ndoshta do të bija në përsëritje të kota dhe jo shumë interesante për lexuesin. Por, për disa gjëra u dashka folur pa mbarim, përderisa asgjë nuk ndryshon!

6, 4% është përqindja e deputeteve femra në parlamentin shqiptar. Një shifër mjaft e ulët. Shumëkush mund të thotë që edhe në shumë shtete të tjera kjo përqindje është e ulët. Kjo është e vërtetë. Por, duke pranuar këtë fakt, nuk e zgjidhim problemin dhe aq më keq, nuk justifikojmë mungesën e progresit.

Para disa ditësh po flisnim me një mikun tim studiues për kuotën 30% të deputeteve femra në parlament (30% sepse është minimumi i duhur në mënyrë që të ketë edhe reflektim të deputeteve femra në vendimet e marra). Duke qenë e sigurtë, po i shprehja rezervat e mia për vënien e kuotave të tilla, që në njëfarë mënyre, krijojnë vetvetiu një ndarje ndërmjet dy seksëve, gjë të cilën ne duam të evitojmë. Sepse, vënia e kuotave më dukej një fuqizim artificial i gruas, të cilin sërish duhet ta evitojmë dhe deri diku, vazhdoj të ruaj këtë ide. Një nga arsyet e tjera të mia ishte se një përqindje të lartë deputetesh femra ne e kemi pasur gjatë periudhës së komunizmit. Në të vërtetë, rezultoi se një pjesë e emancipimit kishte qenë thjesht artificial. Pabarazia ishte e pranishme në marrëdhëniet familjare apo dhe në mendësinë e njerëzve (kjo është më e vështira dhe me problematikja) dhe kjo u pa qartë me rishfaqjen e mendësive dhe sjelljeve nënvlerësuese (në disa raste shtypëse) për vajzat dhe gratë, menjëherë pas fillimit të viteve '90.

¹⁹ Botuar më parë në gazetën "Ballkan", datë 28 prill 2005.

Pra, përqindja e lartë e femrave në parlament nuk u përkthye me një progres të vazhdueshëm drejt barazisë gjinore ose mundësive të barabarta për të dyja gjinitë.

Kështu, që ndoshta pabarazia gjinore nuk u dashka luftuar me vënien e kuotave, por duhet filluar me edukimin e shoqërisë, që do të thotë me edukimin e meshkujve dhe sidomos femrave me konceptin e të qenit të ndryshëm, por njëkohësisht, të barabartë dhe të lirë.

Miku im nuk ishte shumë dakord me mua, duke e argumentuar vënien e kuotave me faktin se nga diku duhet filluar dhe ndonjëherë gjërat duhen bërë të forcuara, në mënyrë që pastaj të marrin rrjedhën e tyre. Debati ynë u mbyll pa ndonjë përfundim të saktë e të qartë, gjë që do të ishte vërtetë çudi po të kishte ndodhur. Ditë më pas, lexova nëpër gazeta dhe dëgjova në televizione faktin se pjesëmarrja e kandidatëve gra për deputete kësaj rradhe është shumë më e ulët, dhe se partitë politike, në disa raste kishin shkelur madje dhe statutin e tyre, përta i përket përqindjes së kandidatëve gra. Duke dëgjuar shifrat 20% kandidatë për deputete femra, (ishte ne statutin e një prej partive) më lindi pyetja se si është llogaritur kjo shifër, dhe pse 20% dhe jo 25 apo 45 apo X% tjetër?! Megjithatë, duke qenë kjo një pyetje e brendshme e rangut të dytë për nga rëndësia, le të kthehemi tek çështja kryesore: përqindja shumë e ulët e kandidatëve për deputete femra në zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Dhe kjo ndodh ndërkohë që, prej kohësh, dëgjojmë për seminare, konferenca e aktivitete të tjera mbi barazinë gjinore përta i përket pjesëmarrjes në nivelet vendimmarrëse apo institucionet e tjera të rëndësishme.

Ndërkohë, shifrat tregojnë se përqindja e grave në forcat e punës është shumë më e ulët se e meshkujve. Kjo nuk duket vetëm nga shifrat; mjafton të dëgjosh emisionin e mëngjesit tek një prej stacioneve radiofonike kombëtare, për të kuptuar se sa vajza të reja, pasi mbarojnë një shkollë, rrinë në shtëpi, pa asnjë lloj objektiv apo plani për të ardhmen.

Le ta përsërisim: është një panoramë e trishtueshme

...përqindja e lartë e femrave në parlament nuk u përkthye me një progres të vazhdueshëm drejt barazisë gjinore ose mundësive të barabarta për të dyja gjinitë.

dhe tepër fatkeqe, ndërkohë të gjithë flasin për rëndësinë e barazisë gjinore!

Por, proceset drejt barazisë gjinore nuk mund të jenë të njëanshme, dhe përkrah vënies së kuotave duhet të vazhdohet, apo madje të fillohet edukimi i femrave dhe meshkujve me idenë e barazisë, me idenë se askush nuk është zot i tjetrit, në mënyrë që në televizionet shqiptare të mos shfaqin më dokumentarë rrënqethës mbi gjendjen e grave në zona të ndryshme të Shqipërisë.

Duke parë shifrat e fundit për pjesëmarrjen në zgjedhje, iu riktheva kuotave dhe ligjërimit të tyre. Ndoshta, ideja ime se gjërat nuk duhen forcuar, por duhen lënë që të ndodhin natyrshëm, ishte shumë e bukur për t'u realizuar. Askush s'e mohon dot se sa shumë është folur këto katër vitet e fundit për çështjen e barazisë gjinore, madje së fundmi u aprovua dhe një ligj mbi këtë çështje. Por, ja ku jemi përsëri, në një situatë që duket sikur ka regresuar, në vend që të evoluonte në mënyrë pozitive. Dhe me keqardhje më duhet të pranoj se disa gjëra duhen bërë «me forcë» në fillim; ligjërimi i kuotave për pjesëmarrjen e femrave në parlament apo në institucione të tjera vendimmarrëse qenka i nevojshëm të paktën në situatën e tanishme që po kalon shoqëria shqiptare.

Por, proceset drejt barazisë gjinore nuk mund të jenë të njëanshme, dhe përkrah vënies së kuotave duhet të vazhdohet, apo madje të fillohet edukimi i femrave dhe meshkujve me idenë e barazisë, me idenë se askush nuk është zot i tjetrit, në mënyrë që në televizionet shqiptare të mos shfaqin më dokumentarë rrënqethës mbi gjendjen e grave në zona të ndryshme të Shqipërisë.

Në qoftë se duam të bëjmë diçka, përveç ligjërimit të kuotave, duhet të mendojmë se si shoqëria të zvogëlojë “riprodhimin” e pabarazive dhe jo vetëm atyre gjinore. Dhe dy institucionet kryesore përgjegjëse për “riprodhimin” e pabarazive janë shkolla dhe familja. Ndoshta është më mirë që analizën e kësaj teme ta vazhdojmë njëherë tjetër, “ndoshta pas zgjedhjeve”, siç po dëgjojmë rëndom këto ditët e fundit...

Gratë në drejtim Shtrohet rruga që brezat e rinj të arrijnë më larg ²⁰

Dorina Hamzallari

Në rrekjet dhe rropatjet për t'u ngritur, mërzitësh shpesh me veten pse askush nuk të mësoi si përdoren bërrylat. Kështu, nuk do të ishe rrëzuar ti, por ai që do të kishe goditur me apo pa dashje. Por, edhe nëse kjo hyn në ato gjërat që në jetë kanë etiketën “nuk duhen bërë”, ndoshta duhen mbyllur sytë dhe të lësh të tjerët të ikin përpara, duke mbytur krenarinë dhe ambicien. Bashkë me këto, edhe ndonjë ndjenjë tjetër nga ato që provon kur rrotullohesh në karrigen çuditërisht gjithmonë të madhe dhe të rehatshme të shefit. Më falni! Thashë “shefit”! Mbase sepse gjithmonë është “ai”.

Diana Çuli, një shkrimtare e njohur, po aq sa edhe aktiviste e shoqërisë civile, pohon se sektorët prioritarë, si: shëndetësia dhe arsimi, mbahen dhe mbështeten pothuajse krejtësisht në punën e grave e megjithatë, drejtuesit janë burra. Po kështu, edhe në profesione të tjera shumë rrallë qëllon që një gazetare, pasi ka punuar në terren, të shkojë në një studio dhe të japë një koment - analizë për një ngjarje të caktuar. Sepse edhe me këtë merren burrat.

Në shumë shkrime dhe komente me zë në televizione, thuhet se hapen dyer e dritare ku gruaja mund të kalojë për t'u afruar tek postet në drejtim. Madje ka akoma nga ata që premtojnë.

Shifrat thonë se besimi i femrave për një ditë të tillë të afërt është lëkundur disi, por jo aq sa të humbasin shpresën

Në shumë shkrime dhe komente me zë në televizione, thuhet se hapen dyer e dritare ku gruaja mund të kalojë për t'u afruar tek postet në drejtim. Madje ka akoma nga ata që premtojnë.

²⁰ Botuar për herë të parë në gazetën “Metropol”, datë 14 Prill 2005, faqe 10.

Ndryshimi i mentalitetit kërkon kohë. Nuk është njëlloj sikur po ndërton diçka dhe mund të planifikosh se kur përfundon. Mund të kërkojë vite të gjatë për të pritur qoftë edhe një reagim sado të vogël, dhe kjo gjë duhet të shërbejë thjesht si shtysë për të vazhduar akoma.

se zëri i tyre do të dëgjohet po aq fort nga podiumet apo qoftë edhe karriget e thjeshta të zyrave dhe jo vetëm kaq. Rreth 47% e tyre mendojnë se niveli i grave në përfaqësim do të rritet në të ardhmen dhe vetëm 35% e tyre besojnë se ky nivel do të ulet. Duke hequr mënjanë shifrat dhe duke folur për atë që shihet me sy të lirë, gratë kanë ndryshuar ndjeshëm mentalitetet e tyre. Më shumë ato që jetojnë në qytete të mëdha (kjo nuk është gjithmonë e thënë për çdo rast). Duam të besojmë se duken të ndryshuara gjithashtu edhe ato femra në zonat rurale, të cilave emigrimi i burrave u ka rënduar peshën e punëve dhe përgjegjësive, por vazhdojnë të jenë të ndërgjegjshme se kërkesat e tyre nuk kanë mbetur më në stadin e barazisë së gruas me burrin. Megjithatë, duhet thënë se është punuar shumë me to.

Ndryshimi i mentalitetit kërkon kohë. Nuk është njëlloj sikur po ndërton diçka dhe mund të planifikosh se kur përfundon. Mund të kërkojë vite të gjatë për të pritur qoftë edhe një reagim sado të vogël, dhe kjo gjë duhet të shërbejë thjesht si shtysë për të vazhduar akoma.

Modeleve të cilat duhet të referohemi janë të rrallë, apo mbase më shumë të panjohur. Shkruhet pak, flitet akoma më pak. Gratë shqiptare, deputete, drejtuese të organeve vendore në gjithë vendin, nuk kanë aq shumë shanse për të folur për punën e tyre, se si ia arrijnë të bëjnë disa role njëherësh në jetë për të qenë aty ku janë. Anëtarët e Parlamentit Europian tregojnë për peripeci dhe vështirësi në kombinimin e jetës mes familjes dhe politikës, ku njëra prej tyre duhet të lihet paksa në hije dhe gati gjithmonë kjo është familja. Dr. Gabriele Stauner, anëtare e këtij Parlamenti shprehet se përveç kësaj, gratë afrohen më pak në drejtim për shkak të modestisë së tyre të tepruar. Ndërkohë që ka edhe një shembull tjetër shumë domethënës. Heidi Hantala, anëtare tjetër e Parlamentit Europian përfaqësuese e Partisë së Gjëbër të Finlandës, thotë se në vendin e saj duhet të kujdesen për të futur shpesh burra në vendet në drejtim, në mënyrë që të ruajnë ekuilibrin e raportit të përfaqësimit.

Përpos atyre që thuhet në fushata elektorale, vetë gratë janë duke punuar dhe luftuar që shumë shpejt të jenë një numër shumë më të madh në drejtim. Sërish, sipas Çulit, më shumë gra në parlament do të krijonin një atmosferë krejt tjetër, çështjet dhe problemet do të diskutoheshin dhe trajtoheshin ndryshe. Madje, edhe një kryetare komune do ta bënte sa më të drejtë ndarjen e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve të tjera të nevojshme sociale. Ajo do të ishte në gjendje të kuptonte më mirë ato që një grua me lot në sy, teksa shtrëngon fëmijën në krahë, i thotë se lista në dyqanin e bukës është bërë tejet e stërgjatë. Sepse dinë t'i shohin gjërat më mirë në sy, duhet të kenë më shumë besim se janë të afta të drejtojnë po aq sa edhe burrat. Këtë këshillë japin përfaqësueset e Parlamentit Europian. Më shumë besim! Modestia ka mbaruar që tek qënia e saj në dy vende njëherësh dhe fort tek të dyja, në zyrë dhe në shtëpi. Nuk ka më kuptim të flitet për të, në kohën kur orari zyrtar ka mbaruar dhe tryeza e shtruar ka mbledhur gjithë familjen.

Dhe, për sa kohë burrat nuk e vënë asnjëherë në dyshim se sapo të hyjnë në shtëpi, do të ndiejnë aromën e gjellës dhe fëmijët duke bërë detyrat, nuk duhet të dyshojnë edhe që gratë e tyre dinë po aq mirë të menaxhojnë edhe më shumë se një familje.

Tashmë, ka kaluar koha kur gratë në politikë shiheshin me paragjykim dhe mosbesim. Këtë e bënë të mundur ato pak femra që sot përfaqësojnë forca të ndryshme politike, grupime apo lëvizje. Por, nëse këto do të ishin edhe më shumë, tani, trampolina për t'u hedhur nuk do të dukej gjithmonë si një rrugë e rrezikshme e me shumë andralla. Nga ana tjetër, ndoshta pikërisht ky fakt mund të shërbejë si një nismë që nesër të kërkojë të jesh edhe më shumë në numër. Në fund të fundit, le të dalë dikush të thotë se nuk është mërëzitur nga njerëzit që nuk e dinë se gruaja është e aftë të drejtojë, se mundet të durojë akoma sytë paragjykes që presin nga çasti në çast që ajo të shkasë e të gabojë për të pretenduar me të madhe se "gruaja e ka vendin vetëm në shtëpi". Edhe në këtë kohë ka shumë nga

...për sa kohë burrat nuk e vënë asnjëherë në dyshim se sapo të hyjnë në shtëpi, do të ndiejnë aromën e gjellës dhe fëmijët duke bërë detyrat, nuk duhet të dyshojnë edhe që gratë e tyre dinë po aq mirë të menaxhojnë edhe më shumë se një familje.

Goftë edhe sikur të duhen vite të gjata, me rrezime dhe ngritje nga e para, të jeni të sigurtë se gratë do të vazhdojnë të ecin. Nëse arrijnë pak për veten, për brezat e tjerë të rinj sigurisht që do të jetë më tepër. Nuk duhet harruar se përpara se shumë prej tyre të bëhen një ditë të afërt politike dhe përfaqësuese të afta, janë nënat që përpiqen që ditët më të bardha t'i gëzojnë brezat që vijnë pas...

këta derisa dikush të fillojë të mendojë ndryshe. Deri atëherë gratë do të kenë arritur në një finale të luftës dhe përpjekjeve të tyre në përmirësimin e legjislacionit shqiptar dhe ndryshimit të mentaliteteve.

Qoftë edhe sikur të duhen vite të gjata, me rrëzime dhe ngritje nga e para, të jeni të sigurtë se gratë do të vazhdojnë të ecin. Nëse arrijnë pak për veten, për brezat e tjerë të rinj sigurisht që do të jetë më tepër. Nuk duhet harruar se përpara se shumë prej tyre të bëhen një ditë të afërt politike dhe përfaqësuese të afta, janë nënat që përpiqen që ditët më të bardha t'i gëzojnë brezat që vijnë pas...

Tani është radha jonë ²¹

Zefina Hasani

Një sfidë e re përballë politikanëve të njohur. Me taktikat e herës së parë. Beteja sapo ka filluar. Kandidatet e PS-së, Mimi Kodbeli e Majlinda Keta dhe Filloreta Kodra e L SI-së, tregojnë pikat e tyre të forta në garën e zgjedhjeve parlamentare.

Mimi Kodheli 40 vjeç, prefekte për Qarkun e Tiranës. Do të kandidojë si deputete, duke përfaqësuar Partinë Socialiste, në zonën 31 të Tiranës.

Në zyrën e fundit të katit të fundit të godinës së Prefekturës së Tiranës, çuditërisht nuk të pret një prefekte e krehur dhe e grimuar me shumë kujdes. Flokët i ka të mbledhura bisht, ndërsa sytë i ka të lodhur, nga orët e pakta të gjumit... . “Më është dashur të rri mbrëmë deri vonë për të përgatitur fjalimin që do të mbaj në kongres”. E ka fjalën për Kongresin e 5 majit të Partisë Socialiste.

Nuk është e veshur chick dhe as nuk është e kapardisur mbi taka të larta. Ka zgjedhur veshjen më praktike dhe këpucët më të sheshta. “Ato me taka i kam vendosur në cep të garderobës, sepse e di që për ca kohë nuk do të më hyjnë më në punë”. E ka fjalën për gjithë kohën që do t’i duhet të zhvillojë fushatën e saj elektorale. Është pikërisht ky angazhimi më i ri, që ia ka marrë Mimi Kodhelit edhe të paktat orë të lira që i kishin mbetur për veten. Por, ndien se ka prapë të tjera energji edhe për këtë betejë. Më mirë se ajo vetë, këtë e di edhe ai që e ftoi në fushatë, kreu i Partisë Socialiste, Fatos Nano, i cili me sa duket, ka piketuar pikërisht ato femra, që i duhen në këto

²¹ Botuar më paë në revistën “Klan”, datë 14 Maj 2005, faqe 22-25.

... është e bindur se tashmë e ka shënuar golin e parë në portën e kundërshtarit, me përgatitjen e saj. Jo aq me diplomimin me rezultate të shkëlqyera në Fakultetin e Ekomikut, me eksperiencën në Bankën e Tiranës e me Masterin në Universitetin e Nebraskës në SHBA, e as me përvojën si drejtuese në Bankën Amerikane, sesa me misionet e saj më të fundit: si Nënkryetare në Bashkinë e Tiranës dhe tani si Prefekte në Qarkun e Tiranës.

zgjedhje të reja. Ato që kanë treguar se dinë të bëjnë gjithçka në emër të karrierës.

Mimi Kodheli e di shumë mirë se me kë do të përballet dhe se në ç'zonë do ta zhvillojë betejën e saj. Ftesa i erdhi nga të tjerët, ndërsa zonën e zgjodhi vetë. “Do të kandidoj në zonën 31, në lagjen ku kam lindur, jam rritur e ku vazhdoj të jetoj edhe sot e kësaj dite”. Në po atë lagje ku është rritur dhe rivali i saj kryesor, kandidati i PD-së. Ajo e di fare mirë se do t'i duhet të luajë në të njëjtën fushë, të cilën Bamir Topi e njeh po aq sa dhe ajo.

Por, është e bindur se tashmë e ka shënuar golin e parë në portën e kundërshtarit, me përgatitjen e saj. Jo aq me diplomimin me rezultate të shkëlqyera në Fakultetin e Ekomikut, me eksperiencën në Bankën e Tiranës e me Masterin në Universitetin e Nebraskës në SHBA, e as me përvojën si drejtuese në Bankën Amerikane, sesa me misionet e saj më të fundit: si Nënkryetare në Bashkinë e Tiranës dhe tani si Prefekte në Qarkun e Tiranës.

“Përvoja në Bashkinë e Tiranës është guri më i fortë që ndiej se e kam në duar. Pa atë gur s'besoj se do ta kisha nisur këtë ndeshje politike”. Atëherë ndoshta as Z. Nano nuk do t'ia kishte bërë ofertën për kandidim. “Ftesa erdhi drejtpërdrejt prej tij dhe kjo nuk më çudit. Them se erdhi si rrjedhojë logjike pas rritjes sime në karrierë”. Karrierë që nuk do të zhvillohej më vetëm në fushën e saj të financës, por edhe në atë të politikës, pas ftesës që Edi Rama i bëri për ta pasur si krahun e tij mbështetës në Bashkinë e Tiranës. Atëherë Mimi ndoshta nuk e kishte menduar zhytjen në politikë kaq thellë, por pas çastit kur mori ftesën e Fatos Nanos, për ta trasmetuar përvojën e marrë në Bashki, në të gjithë Qarkun e Tiranës, u përgatit edhe për një çast të tillë, kandidimin.

Që prej janarit të këtij viti, kur u emërua prefekte, Kodheli e ka pasur gjithë kohën e mundshme për të njohur problemet edhe më gjerë, kështu që zonën e saj të vogël, brenda Tiranës së madhe nuk do ta ketë të vështirë ta vërë nën kontroll. “Nëpërmjet shtabit tim të punës jam informuar për të gjitha

problemet e zonës sime dhe shumë shpejt do të nis takimet e drejtëpërdrejta me banorët”. Do të përpiqet që kur të trokasë në dyert e tyre ata të kuptojnë se është ajo vajza që banon në portën karshi. “Ata që më kanë njohur para dhe pas pushtetit nuk e kanë të vështirë ta besojnë këtë e të kuptojnë se unë jam po ajo Mimi me virtytet dhe defektet e saj, por thjesht ca e shtyrë në moshë. Por, edhe ata që s’më njohin, do ta kuptojnë se unë jam një banore e lagjes së tyre, që tani ka mundësi për të bërë diçka më shumë për ta, e jo vetëm si prefekte, por edhe si deputete.” Duket qartë se përgatitja dhe përvoja profesionale është vërtet një pikë e saj e fortë në këtë betejë të hapur. Të tjerë mund të thonë se një pikë tjetër e fortë e saj qëndron dhe tek trupi dhe sytë e bukur. Megjithatë, edhe kaq nuk mjafton për një fushatë.

Duhet mësuar edhe “taktika” për të bindur të tjerët të të votojnë, apo siç preferon ajo të thotë “për të të besuar më shumë”. Dihet që Mimi Kodheli e ka për herë të parë një angazhim të tillë, e mund të mendohet se nuk do të dijë të bëjë fushatë ashtu siç duhet. Por, ajo vetë të jep argumenta për të kundërtën e kësaj, “Kam marrë pjesë në një program të departamentit të shtetit ‘Gratë në politikë’, kam qenë në Amerikë para zgjedhjeve dhe u njoha me mënyrat e organizimit të një fushate pikërisht në vendin ku fushata është kthyer në art. E kësaj ane teorike, i shtoj dhe anën praktike, përvojën në fushatën e Edi Ramës”. Nuk do të jetë aspak çudi nëse në fushatë do të shohim një Mimi shumë *trendy*.

“Nuk do të bëj fushatë me premtime, por me një platformë ku do të prezantoj të gjitha projektet e Bashkisë së Tiranës, që janë në përfundim e sipër e që i përkasin zonës sime. Nuk do të fus nën dyer fletushka me fjalë boshe, por me projektet e rrugëve, lulishteve, shkollave që janë të hartuar në Bashkinë e Tiranës që nga koha kur unë isha atje.”

Do të ketë gjithashtu në këto fletushka një prezantim i asaj që ka përfunduar dhe asaj që do të bëhet. Ka marrë përsipër ta ndryshojë atë zonë që ka më për zemër. E përderisa misioni i saj si prefekte është të ndryshojë gjithë Tiranën, për ta bërë

një metropol të vërtetë, pse jo dhe me një dalje në det (ëndrra e lashtë e çdo tiranasi), misioni si deputete, për të ndryshuar zonën ku është rritur do të jetë shumë më i lehtë.

Majlinda Keta 42 vjeç, Drejtoreshë në Drejtorinë Arsimore Rajonale për qytetin e Tiranës. Do të kandidojë si deputete, duke përfaqësuar Partinë Socialiste në zonën 40 të Tiranës.

Një tjetër zonjë ka marrë misionin të ndryshojë gjithashtu zonën ku është rritur. Majlinda Keta do të jetë përballë Gëzim Karapicit, kandidat i PD-së, Dashamir Shehit të LZHK-së dhe Sokol Nakos së LSI-së në zonën 40 (që përfshin Njësinë Bashkiake nr. 2 dhe nr. 10). E reflekton qartë që ndihet mirë përballë të treve, me një siguri që asaj ia jep përgatitja dhe përvoja në fushën e arsimit. Në fare pak vite arriti të ngjisë disa shkallë në karrierë: nga një mësuese e thjeshtë e filozofisë, në asistente pedagoge në Fakultetin e Filozofisë, në drejtoreshë të Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Arben Broci” e së fundi Drejtoreshë në Drejtorinë Arsimore Rajonale të Tiranës.

Një ritëm i tillë edhe mund t'i 'trembë' paksa rivalët e saj, sepse tregon se M. Keta për të arritur qëllimet që i vë vetes, lëviz gjithë botën nën këmbët e saj. Këtë gjë, ajo mund ta bëjë edhe për fushatën e saj.

Një ritëm i tillë edhe mund t'i 'trembë' paksa rivalët e saj, sepse tregon se M. Keta për të arritur qëllimet që i vë vetes, lëviz gjithë botën nën këmbët e saj. Këtë gjë, ajo mund ta bëjë edhe për fushatën e saj. Kështu do të thonin ata që e njohin, ndërsa ajo vetë quan më shumë si pikë të fortë mbiemrin e saj prej një familje puro tiranase dhe dëshmorësh mbi të gjitha, si dhe angazhimin e saj në shoqërinë civile për çështjet e arsimit në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Socio - Ekonomik. Në fakt, ky është vërtet një angazhim shumë i rëndësishëm për atë që ajo do të synonte më pas, politikën. Që aty do të lidhej më fort me rrethin e politikanëve. Nuk mund të ndodhte ndryshe, edhe në këtë terren të ri ajo do të kërkonte të ishte ndër të parat.

“Ishte një vullnet i shpallur që në momentin kur fitova me konkurs postin që kam dhe sot si Drejtoreshë e Drejtorisë Arsimore Rajonale për qytetin e Tiranës. Kërkova të anëtarësohem në Partinë Socialiste dhe e mora pa shumë zhurmë taserën.” Kaq kishte menduar ajo, rritjen më tej edhe

në politikë ia kishte planifikuar vetë Nano. “Propozimi për të kandiduar më erdhi direkt prej tij”. Edhe pse nuk kisha qenë një militante e partisë, baza më mirëpriti, ndoshta pse kishin parasysh gjithë punën time. “Tani që i ka kaluar të gjitha fazat për të mbërritur në fushatë, Keta është e qetë dhe duket se i ka vënë në vijë punët. Do të jetë një fushatë normale, pa shumë parada, por me njerëz që i ka zgjedhur me shumë kujdes. Me një shtab elektorale me shumë të rinj, që duan të ndihmojnë ish zyshën e tyre e me shumë gra që kanë arritur t’i besojnë kryetares së Forumit të Gruas Socialiste.

Filloreta Kodra ka pranuar një sfidë më të vështirë se gratë e Partisë Socialiste. Do të kandidojë në zonën rurale. Por, e parë me një sy tjetër, kandidatja e LSI-së, përballë rivalëve meshkuj (Edmond Spahon e PD-së dhe Fehmi Xhemin e PS-së) në zonën 83, mes Pogradecit dhe Korçës, duket se ka një shans më shumë se të tjerat. Është hera e parë që një zonjë nga qyteti, shkel në fshatra të harruar. Edhe pse veç origjinës prej Korçe, asgjë tjetër nuk e lidhte me atë zonë, kryesia e Korçës dhe Pogradecit kanë zgjedhur Filloretën si kandidatë. Dhe Filloreta duket se e ka kuptuar dhe është pënduar që “Në fillim mendoja të më jepnin ndonjë zonë brenda Tiranës”, thotë duke qeshur dhe të shpjegon sepse ndoshta këtu nuk do ta kishte shumë të vështirë të prezantohej. Këtu janë të shumtë ata që e njohin me fillimet si një specialiste për statistikat në Ministrinë e Arsimit, atë të Kulturës më pas, pastaj në drejtorinë e pagave në Ministrinë e Financave, tek ajo e Punëve dhe Çështjeve Sociale, ku do të emërohej edhe si drejtoreshë në Drejtorinë e Politikave Sociale, pas 1998-ës edhe si drejtoreshë në Administratën Publike në Këshillin e Ministrave dhe së fundi si këshilltare në misionin e Republikës së Shqipërisë pranë Kombeve të Bashkuara në Gjenevë, nga ku do të largohej për të ardhur pranë LSI-së, me ftesë të Ilir Metës.

Ndërsa në zonën e largët, do t’i duhet të gjejë gjuhën më të thjeshtë për t’ua shpjeguar zgjedhësve gjithë këto përvoja të karrierës së saj. “Do të mjaftojë t’u bëj të ditur gjithë punën që

Një gruaje që di të bëjë reformë në qytet, banorët e zonave rurale e kanë të lehtë t'i besojnë, se edhe në zonën e tyre ajo mund të bëjë ndonjë mrekulli. Ata nuk kërkojnë ndonjë çudi të madhe, por thjesht që të arrijnë të shijojnë të paktën rezultatin e punës së tyre.

kam bërë me pagat në administratën shtetërore, se kam njohur mirë mekanizmin e shtetit në të dy sistemet, se kam qenë e angazhuar në lëvizjet e sindikatave të punëtorëve në kohën e protestave të tyre për rritjen e pagave, lëvizje këto që më krijuan detyrimisht lidhje më të ngushta me çështjet politike. Mjafton t'u sqaroj zgjedhësve të mi se jam përpjekur të bëj reformë në administratën publike për ta shkëputur atë nga politika e, se në këtë përpjekje, bashkëpunimin më të mirë e kam pasur me Z. Ilir Meta, kur ai ishte kryeministër.”

Një gruaje që di të bëjë reformë në qytet, banorët e zonave rurale e kanë të lehtë t'i besojnë, se edhe në zonën e tyre ajo mund të bëjë ndonjë mrekulli. Ata nuk kërkojnë ndonjë çudi të madhe, por thjesht që të arrijnë të shijojnë të paktën rezultatin e punës së tyre.

“Dhe ky do të jetë premtimi im kryesor”, saktëson kandidatja e LSI-së, e cila për këtë fushatë është kapur shumë pas grave. Ato i janë dukur më të emancipuara se burrat, më të arsimuara së burrat. Filloreta ka arritur të organizojë sërish gratë e zonës rurale po ashtu si 15 vjet më parë, kur, pas punës në fushë, ato mblidheshin në mbrëmjet e dëfrimit kolektiv. Tani nuk mblidhen për mbrëmje vallëzimi, por për çështje pune, për fushatën elektorale të mikes së tyre të re.

Gratë, politika dhe kriteret e barazisë ²²

Flora Nikolla

Sikundër e tregon e tashmja, duket se ende gruaja vazhdon të mbetet sa protagoniste, por aq edhe e rezervuar në jetën politike. Këtu nuk bëhet fjalë për përqindjet e pjesëmarrjes së saj në jetën politike, e cila si gjatë një sistemi të kaluar ashtu edhe tani, duke iu referuar statistikave, është herë në rritje e herë në rënie apo edhe anasjelltas. Këtu bëhet fjalë për raportin real dhe njerëzor që ka politika me gratë dhe gratë me politikën. A nuk ju duket jo rrallëherë si një farsë pjesëmarrja e gruas në jetën politike? A nuk ju duket se politika e përdor pjesëmarrjen e saj për të treguar transparencën në lidhje me gjysmën e popullsisë? Hartohen programet e partive, sidomos kur ato ndryshojnë dhe rinovohen në prag fushatash elektorale...! Dhe në programet e të gjitha llojeve të partive, të majta apo të djathta, të qendrës apo ekstreme, tregohet se sa shumë do të rritet mirëqenia në qeverisjen e re, tregohet rritja e pensioneve të popullsisë së moshës së tretë, tregohet edhe rritja e nivelit të popullsisë, dhe pastaj sigurisht që në këto programe nuk mungojnë edhe shifrat dhe përqindjet e pjesëmarrjes së gruas në politikë, në jetën shoqërore

Pse?! Pse vallë politikës i duket një detyrim apo edhe një motiv më shumë që programet e tyre mund të fitojnë edhe me vendin që ata i lënë gruas në vendimmarrje apo në jetën politike të një shoqërie? Pse duhet që kjo gjë të jepet si një pozitivitet apo edhe progres kur prej kohësh në botë dhe prej disa vitesh edhe në Shqipëri flitet për barazi gjinore? Pse duhet që të krijohet ideja që përqindja e grave në këtë strategji të vihet në funksion të fitimit apo jo të programit të partive përkatëse? A nuk është tashmë e konfirmuar se gratë janë një pjesë integrale

²² Botuar për herë në parë në revistën e përjavshme "Kult", datë 20 Prill, faqe 1.

dhe po aq e vlerë në vendimmarrje sa pjesa e politikës që bëjnë burrat në kuadrin e një partie? Ndaj them pse politika e burrave është e detyruar të luajë sa edhe të pranojë pjesëmarrjen e gruas në politikën që ata e dominojnë.

Çfarë lidhje ka krijuar shteti me lëvizjet feministe? A ka qenë ai një aleat apo një armik i gruas? Si ka funksionuar bashkëpunimi mes lëvizjeve të grave të pavarura dhe grave të futura në jetën politike apo në planin lokal të qeverisjes?

Mos vallë barazia mes burrave dhe grave vazhdon të trajtohet dhe të bazohet kryesisht në ndryshimet biologjike mes tyre?!

Kjo nuk ka pse të ndodhë, nëse i referohemi vullnetit dhe protagonizmit të grave, sikundër edhe strategjive me vlerë që ato i sjellin politikës të cilat janë shumë më efikase se sa ato të politikës që mund të sjellin burrat në jetën integrale të një shoqërie. Pra, kemi dy kahe. Kahu i shifrave që përkon me strategjitë e partive për të qenë transparente në programet e elektorale të tyre dhe për të plotësuar këtu një program edhe me pjesëmarrjen e gruas në politikë dhe në vendimmarrje, dhe nga ana tjetër, me protagonizmin e vullnetshëm dhe forcën aktive femërore, e cila di të bëjë ndoshta shumë herë më mirë se sa burrat një platformë, apo të japë një ide dhe të dijë të marrë vendime pa kahe përdorjeje. Pastaj këtu lindin edhe një sërë temash kyçe kur fillon dhe analizon gjendjen e gruas në politikë dhe në vendimmarrje. Për shembull, këtu më lindin pyetjet: Çfarë lidhje ka krijuar shteti me lëvizjet feministe? A ka qenë ai një aleat apo një armik i gruas? Si ka funksionuar bashkëpunimi mes lëvizjeve të grave të pavarura dhe grave të futura në jetën politike apo në planin lokal të qeverisjes? Si dhe sa janë realizuar problemet e gruas dhe sa ka qenë barazia gjinore e arritur brenda kuadrit të një qeverisjeje?

Mos vallë barazia mes burrave dhe grave vazhdon të trajtohet dhe të bazohet kryesisht në ndryshimet biologjike mes tyre?!

Nëse shohim strategjitë që janë përdorur për të promovuar vendin e gruas në politikë, duket sikur çdo gjë ndodhet në vendin e vet... Po unë po ribëj pyetjen... Përse vendimarrja e grave në politikë duhet të ketë përqindje? Mos vallë kjo është një pikë e pashmangshme e programeve të partive, apo forca e gruas detyron që edhe në këto programe ato duhet të jenë sa të pranishme po aq edhe të qenësishme...?!

Botë të ndryshme në postera “bambolash”²³

Laureta Roshi

“Bota ndryshon me gratë në vendimmarrje” është një nga shënimet mbi posterat e fushatës elektorale. Shënim që rrëzohet nga shifra e ulët, **vetëm 38 kandidatë deputete janë vendosur në listat e partive politike!** Një përfaqësim i destinuar drejt zhdukjes, pavarësisht deklaratave të liderëve politikë se tashmë gratë konsiderohen në politikë si një forcë ndryshimesh. Të ideuara brenda kryesive të partive, emrat e botuar në shtyp deri tani tregojnë se përfaqësimi i grave si kandidatë për deputete është sa 8% e pjesëmarrjes së tyre në parti. Një mentalitet i ndryshuar për keq nga klasa politike shqiptare. Pavarësisht se pothuajse në statutet e partive është shënuar edhe kuotimi i kandidimit të grave nga 20 deri në 30%, partitë mundën ta shkelin edhe legjislacionin e tyre.

Por, edhe kuotimi i plotësuar, nuk tregon shanse për ndryshim. Kuotimi është një tregues i civilizimit, të pakushtëzuar nga politika dhe jo detyrim. Detyrimi mbeti pas në atë sistem ku diktatura e kërkonte emancipimin e grave dhe ky emancipim kushtëzohej po nga politika. Pra, kuotat nuk tregojnë pjesëmarrje. Madje, edhe ato kandidatë të zgjedhura, pohojnë se janë përfshirë në zgjedhje nga fakti se procesi zgjedhor vëzhgohet nga ndërkombëtarët. Por, edhe ato pak kandidatura po ndihen të pa mbështetura. Në njëfarë mënyre misioni i tyre mbaroi, u shënuan në listat e publikuara të partive.

Pse mendoj se misioni i tyre mbaroi? Të vendosura përballë kundërshtarëve burra politikanë, ato nuk kanë shanse të publikojnë dhe bëjnë fushatë me idetë e tyre, me atë çka ideon dhe premtan në programin individual një kandidatë, pasi programi i partisë i unifikon specifikat e kandidatëve. Të bërë

²³ Botuar më parë në gazetën “Ballkan”, datë 14 Maj 2005, faqe 8.

një në lista, edhe ato duhet të presin hapjen e kutive në muajin korrik.

Rrallëherë kandidatet gra, janë mbështetur nga biznesmenët me fonde në fushata; dhe akoma më rrallë paraqiten në media si rivale të vërteta vlerash.

Rrallëherë kandidatet gra, janë mbështetur nga biznesmenët me fonde në fushata; dhe akoma më rrallë paraqiten në media si rivale të vërteta vlerash.

Dhe kjo deri diku i takon mënyrës si bëhen fushatat në Shqipëri, gjithmonë masive, të zhurmshme dhe me shumë rrapullima mbi kundërshtarët. Ndodhi që jo rrallë partitë i zgjodhën kandidaturat e pakta nga gratë jashtë politikës, pra jo të antarësuarat e tyre militante, duke reflektuar edhe njëherë faktin se politika shqiptare nuk ka ndryshuar.

Pavarësisht se burrat shqiptarë politikanë e njohin nevojën e vlerave të kandidateve gra, ato deri aty mbeten. Për t'u paraqitur në elektorat, ato duhet të përpiqen vetëm deri sa edhe kompromiset që bëhen nga të fuqishmit, bëhen duke rrëzuar kandidaturat e grave.

Larg të qenit partnere në politikë, gratë shqiptare po pohojnë dyshime mbi pjesëmarrjen e vërtetë në politikë dhe për rrjedhojë, nga gara eklektorale do të dalin fitues burrat e fortë. Pse burrat e fortë? Gratë do të vazhdojnë të jenë minorancë dhe jo vetëm në politikë, sipas psikologut Edmond Dragoti. Kjo sepse në botë fiton individi me instinktin më të fortë. Dragoti, i përfshirë në politikën shqiptare që në momentin e ndryshimit të sistemeve, pohon se në gjithë botën gratë përfaqësohen në minorancë jo vetëm në politikë. Dragoti beson në natyrën biologjike të qenies. Sipas tij, kjo ndodh për një arsye kryesisht psikologjike. Rrjedhoja është që në krye të çdo grupi shoqëror vihet zakonisht individi më agresiv, më ambicioz dhe njëkohësisht më i fortë. Sipas Dragotit, edhe pse gruaja është rezistente në kohë dhe shquhet për durimin e saj, ajo nuk ka forcën e duhur mashkullore për t'u ngritur në krye. Ndërsa kandidatet gra të grupuara pavarësisht ngjyrave politike, pohojnë se partitë i përdorin ato vetëm për makijazh politik, për t'u dukur në rregull me ndërkombëtarët. Për sa kohë gratë anëtare të forumeve partiake vetë do të pranojnë kompromiset me direktivat e kryetarëve, do të përplasnin duart në mitingje dhe do të harrojnë të mbështetin kandidatet gra, kjo situatë kështu do të vazhdojë... .

Përse hezitohet që gratë të kandidojnë?!²⁴

Antoneta Malja

Shumë probleme mblidhen në momente të veçanta, sidomos para periudhave të tilla sensibilizuese, siç janë zgjedhjet parlamentare. Në mjaft televizione ka filluar turravrapi i politikanëve, duke renditur mrekullitë që e presin këtë popull. Janë këta politikanë që mezi presin t'i "kapin" gazetaret për të folur për aleanca para e pas zgjedhjeve. Por, të trishton fakti kur sheh se në asnjë rast e në asnjë moment nuk flitet e nuk diskutohet për pjesëmarrjen e gruas në vendimmarrje, një problem aq i diskutuar qoftë nga ndërkombëtarët, ashtu edhe nga shoqëria civile. Dhe jo vetëm kaq. Por, kur shkruaj këto rreshta, më duket sikur jam marsiane, në këtë realitet që të gërryen. Sepse të ngresh zërin për kandidimin e gruas në zgjedhje në ato shifra mjerane, të duket sikur kërkon një luks në morinë e problemeve që ka jeta. Shihet që numri i grave "po futet në ujë". Nuk ka mbështetje politike për të ruajtur minimalisht edhe ato kuota që ishin më parë. Një çudi në këtë realitet shqiptar! Nuk e di se me kë vend mund të krahasohemi! Në Europë jo e jo!

Pretekset nga partitë politike janë nga më të shumtat, nën pretekstin se nuk paska zonja për të përballuar fushatën, si nga ana financiare, ashtu edhe lidhur me morinë e problemeve të shumta që përmbledh vetë ajo. Janë gati refren thëniet se *"e mirë dhe e zonja kjo grua, por nuk mund të fitojë zgjedhjet, sepse lufta politike është e egër dhe e dhunshme"*.

A thua se nuk do të konkurohet, por do të shkohet për t'u prerë koka. Pa marrë fund ky realitet, as që mund të shpresohet që të ecet përpara me ritmet që dëshirojmë. Kjo ka edhe një shpjegimin tjetër se, mungon vullneti politik për të mbështetur gruan. Kjo s'është rastësi. Më vjen në mendje një thënie e

²⁴ Botuar më parë në gazetën "Metropol", datë 27 Maj 2005.

publicistit Preç Zogaj: *“Ne jemi pengje të një tradite shekullore ku flitet për zonjat e nderuara. Por, vetë gratë nuk duhet të jenë në pozita pritjeje.”*

Edhe pasqyrimi në media i çështjes së barazisë gjinore në këto zgjedhje, është njëra anë e problemit. Kjo më tepër i lihet rastësisë. Por, më themelorja është tek vetë partitë politike. Ato janë kthyer plotësisht në parti mashkullore. Harrohet me dashje apo për ndonjë arsye tjetër, këtë nuk di ta sqaroj. Një gjë është e lexueshme: se barazia gjinore në vitin 2005 po futet në kalendat greke. Kemi një regres të ndjeshëm. Kur vjen momenti i kandidaturave të zonjave kërkohet “gjilpëra në kashtë”, nxirren njëqind arsye e justifikime. Ndërkohë, nuk ndodh e njëjta gjë me kandidatët meshkuj. Menjëherë dalin nga sirtarët emra pas emrash të atyre me grada shkencore ose jo, me kontribute qoftë në politikë apo në profesion, e për të cilët kam respekt. Por, kurrsesi nuk vete një herë lapsi tek një grua që qoftë për të gjitha ato sa rendita, nuk qëndrojnë më prapa se zotërinjtë. Ndoshta janë edhe disa hapa më përpara, kur mendon se ato administrojnë edhe familjen, edhe fëmijët, edhe gjithçka tjetër në jetë. Të gjitha këto të arritura me punë.

Më duhet t’iu kujtoj atyre që mblidhen në ato zyra ku punon lapsi vetëm për zotërinjtë, se barazia gjinore është një pjesëmarrje e dukshme, e fuqishme dhe barabartë e të dy seksëve në të gjitha fushat e jetës. Ajo synon të nxisë pjesëmarrjen e plotë të grave e burrave në shoqëri. Mirë që sot në Shqipëri nuk arrihet pjesëmarrja e plotë, por do të dëshiroja të shihja në zbatim ato dokumente e statute, ku është parashikuar shprehimisht kuotimi i grave.

Mjafton të kujtoj që në Kosovën e pasluftës, e cila ende s’ka fituar pavarësinë zyrtare, është institucionalizuar kuotimi prej 30% i grave parlamentare.

Ose diku më tutje në kohë... . Ishte viti 1910 kur në Finlandë ishin tre gra parlamentare. Krahasojeni këtë shifër me parlamentin e sotëm shqiptar! Le të kthejmë sytë nga statistikat. Këtu nuk e kam fjalën për 3,5 apo 7, por për tendencën mbytëse dhe aspak inkurajuese për gruan. Pikërisht këtu fillon kontradikta midis maskilitetit dhe feminitetit në politikë, duke

e kthyer politikën vetëm për zotërinjtë. Fushata ka filluar. Dhe ata politikanë që kanë kandiduar, kanë drejtuar sytë nga zonjat. Dihet që ato mbajnë peshën kryesore të fushatës. Edhe njëherë ajo renditet në punët e dorës së dytë. Dhe, si për ironi të fatit, gruaja sot drejtohet dhe orientohet nga 48% e shoqërisë. Më vjen në mendje një shprehje e Matty Thim, që thotë se “nëse do që të fluturojë zogu ai ka nevojë për të dy krahët”.

Ka shumë politikanë që gjatë kësaj periudhe katërvjeçare kanë tjuerur thënie të tilla se, “do të ndryshojnë raportet, se me zonjat jemi borxhlije, se ato meritojnë shumë më tepër etj.”. U ngop opiniononi me premtime boshe! Ajo tashmë përfaqësohet nga zotërinjtë. Atëherë le të dalin e të deklarojnë si dikur “Ne gratë e Shqipërisë do të punojmë për emancipimin tonë”. Por, po mos u habitni! Edhe këtu do të shkohet.

Në mënyrë racionale, besojmë se doza e maskilitetit tek partitë politike është e theksuar. Është ky mentalitet maskilist që i pengon politikëbërësit që të vlerësojnë aftësitë, punën dhe vlerat e gruas. Një burrë është gati të bllokojë një autostradë, ta favorizojë një kontrabandë, drogë apo armë, të hapë dy tre restorante apo kafe masive; ndërsa një gruaje nuk i shkon mendja për mashtrime të tilla, përjashtojnë rast.

Mentaliteti mbytës për gruan nuk ndryshon me një ditë. Aq më tepër, që fenomeni i mospërfaqësimit të saj në Parlament po ngushtohet. Është momenti që këmbanat duhet të bien fort për politikën për të ndërmarrë hapa konkretë, për t'i dhënë gruas vendin që i takon. Ajo përbën 52% të popullsisë.

Mentaliteti mbytës për gruan nuk ndryshon me një ditë. Aq më tepër, që fenomeni i mospërfaqësimit të saj në Parlament po ngushtohet. Është momenti që këmbanat duhet të bien fort për politikën për të ndërmarrë hapa konkretë, për t'i dhënë gruas vendin që i takon. Ajo përbën 52% të popullsisë.

“Liritë dhe të drejtat e tua nuk mund të fitohen nëpërmjet heshtjes”.

Hillary Clinton

Gratë në politikë, sfidë dhe realitet ²⁵

Isidor Koti

Kreu aktual i opozitës shqiptare, gjatë një prezantimi mediatik deklaroi se në vitet në vazhdim, një pjesë të konsiderueshme të figurave të reja politike në spektrin e djathtë do ta zënë gratë. Edhe forcat e majta, përmes përfaqësuesve të tyre, kanë shprehur vullnetin për rritje të numrit të grave në sferën politike. Duket se vendimmarrja në pushtete po bën realitet, edhe pse ende në projekt, përfshirjen e grave në jetën aktive të politikës shqiptare. Madje, edhe nga ata më konservatorët të shoqërisë sonë ky hap shihet me sy pozitiv, përpos faktit se skena politike ka qenë e zaptuar nga të njëjtët aktorë.

Natyrisht, jetës publike në vendin tonë nuk i kanë munguar femrat, të cilat nëse i kthehemi historisë, në revolucionin e famshëm komunist të viteve '70-të u quajtën forcë e madhe e jetës sociale. Raporti numerik nga viti në vit nuk ka ndryshuar shumë, por sidoqoftë, prezenca e tyre ka qenë ekzistente dhe e dobishme. Për t'u vënë në pikëpyetje ka qenë zëri i tyre, postet që kanë mbajtur si dhe prania në jetën publike dhe media. Shoqëria jonë ka qenë historikisht dhe është më e hapur ndaj arritjeve të burrave sesa grave në vendimmarrje. Kjo nuk është vetëm pjesë e mentalitetit. Politikanet femra qortohen nëse marrin mbi vete privilegjet mashkullore. Studimet tregojnë se në veçanti gratë që flasin haptas vlerësohen negativisht, e për çudi sidomos prej vetë grave.

Pengesat ndaj pjesëmarrjes së gruas në politikë janë të shumta. Shumë gra dhe burra mendojnë se politika është

²⁵ Botuar për herë të parë në gazetën "Koha Jonë", datë 21 Mars 2005, faqe 12.

“mashkullore”. Për rrjedhojë, gratë e kanë të vështirë të zhvillojnë vetëbesimin që nevojitet për të kandiduar për poste publike. Pengesat madhore ndaj pjesëmarrjes së grave në politikë janë situacionale, si: mëmësia, qëndrimet shoqërore dhe institucionale. Influencë të konsiderueshme kanë edhe stereotipat gjinorë, të cilët ndikojnë në qëndrimet për kandidatët politikë dhe këto opinione shndërrohen në vota.

Kandidatet gra shqyrtohen më me kujdes sesa kandidatët burra. Në veçanti, moshë, gjatësia, pesha, veshja dhe tërheqja fizike e grave luajnë një rol të madh në faktin sesa seriozisht merren ato si kandidate.

Kandidatet gra shqyrtohen më me kujdes sesa kandidatët burra. Në veçanti, moshë, gjatësia, pesha, veshja dhe tërheqja fizike e grave luajnë një rol të madh në faktin sesa seriozisht merren ato si kandidate.

Por, nuk duhet harruar gjithashtu se për ngritjen e fondeve gjatë fushatave, gratë e kanë pasur më të vështirë në një sistem të tillë politik, ku shumica e politikanëve kanë krijuar akses dhe kërkojnë të rikandidojnë në të njëjtat poste drejtuese.

Gjithmonë është vënë në diskutim nga analistë dhe intelektualë të ndryshëm inteligjenca e grave në punët drejtuese, por testet e inteligjencës nuk kanë dhënë ndryshime sasiore dhe cilësore. Nëse do t'i hidhnim një sy vendeve të tjera, për shembull, marrim modelin amerikan që konsiderohet si më i miri, gratë kanë ecur shumë përpara në procesin e vendimmarrjes. Nga viti '90 e këtej, gratë në Amerikë kanë fituar poste të larta të papara ndonjëherë si legjislatore shtetesh, senatore dhe guvernatore. Edhe ato që nuk kanë fituar zgjedhjet, mund t'i kenë sjellë përfitime grave nga pikëpamja afatgjatë, duke fituar përvojë politike, duke shërbyer si modele për gra të tjera dhe duke edukuar publikun mbi mundësinë e grave si kandidate politike.

Por, edhe në Shqipëri qëndrimet po ndryshojnë dhe po bëhen më pranuese ndaj grave politike. Kjo reflektohet në veprimtarinë e tyre të shumta si në plotësimin e kuadrit ligjor, bashkëpunimin me pushtetin vendor e qendror, etj. Krahasuar me vitet e para, gruaja shqiptare është shumë më e

përgatitur dhe më e motivuar në misionin e saj, madje dhe me ekspertizë në fusha të caktuara si: në hartimin e politikave, në angazhimin për rritjen e përfaqësimit të gruas në vendimmarrjen politike. Arritje të lëvizjes së gruas konsiderohen edhe format e organizimit të saj, që nga organizatat jo-fitimprurëse, deri në koalicione dhe rrjete. Madje, për t'u vënë në dukje, gjithashtu është se lëvizja e gruas në Shqipëri vlerësohet si një ndër lëvizjet më të rëndësishme në Ballkan.

Për më tepër, studimet tregojnë faktin që gratë perceptohen se kanë një avantazh karshi burrave, përse i përket një game të gjerë çështjesh sociale dhe kufizimit të shpenzimeve qeveritare. Ato shikohen si dashamirëse, më të ndershme dhe më të moralshme, sesa burrat. Në këtë situatë, kur pozicioni i gruas në vendimmarrje e politikë nuk shihet më me syze të errëta, forcat politike shqiptare po shpallin si platformë të përfaqësuesve të tyre edhe emrat e grave që kanë krijuar besueshmëri në sytë e opinionit publik.

Nëse priten rezultatet, për t'u bindur se në çfarë niveli do të jetë kontributi i grave në një fushë kaq delikate kur nevojitet të sakrifikosh shumë nga jeta personale dhe familjare, kahu i shikimit duhet drejtuar fillimisht nga hierarkia e pushteteve, e cila mund të lëshojë pe dhe t'i integrojë gratë realisht në politikën shqiptare.